


# Plani vjetor i biznesit 2023

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror



**Versioni 1.0**

**Data e Ver.: 14.11.2022**

## Përbajtja

1. Përbledhje ekzekutive.....	2
2. Objektivat kryesore.....	3
3. Siguria.....	5
4. Burimet Njerëzore.....	6
5. Strategjia.....	7
6. Fushat kyçë Strategjike .....	8
7. Treguesit e performansës .....	14
8. Plani Financiar i ASHNA.....	21
9. Analiza e planit finansiar.....	28
10. Rreziqet dhe ndikimi në planin e biznesit .....	46
11. Skema organizative e ASHNA-së .....	47
12. Azhurnimi i Planit Vjetor të Biznesit.....	48



Njësia Organizative: ASHNA  
Nr. Ref. /Kodi: PBV 2023  
Ver.: 1.0  
Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 1 nga 48

## 1. Përbledhje ekzekutive

Ajencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror e Republikës së Kosovës (ASHNA) është agjensi shtetërore, e themeluar me Ligjin Nr. 04/L-250 për "Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror" (Ligi për ASHNA), me përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Për shkak të kufizimeve që burojnë nga "statusi politik", fushëveprimi shtrihet nga niveli tokë (Ground GND) deri në lartësinë 6,250 m (Flight Level FL 205).

ASHNA veprimtarinë e saj e përkufizon në shtyllat kryesore si në vijim:

- ❖ Shërbimet e Kontrollit të Trafikut Ajror
- ❖ Shërbimet Informative Aeronautike
- ❖ Shërbimet Meteorologjike
- ❖ Shërbimet e Komunikimit, Navigimit dhe Vëzhgimit (Survejimit)

Aktivitetet tona, nga aspekti i sigurisë dhe ekonomik rregullohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës përmes ligjeve dhe akteve nënligjore vendore, si dhe rregulloreve ndërkombëtare të aviacionit civil, kryesisht të Komisionit Europian. ASHNA, sipas ligjit, njeh autoritetin e KFOR-it në çështjet e hapësirës ajrore dhe ruan bashkëpunim të vazdueshëm në çështjet strategjike dhe operative.

Sipas Ligji Nr. 04/L-250 për "Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror", ASHNA i raporton Qeverisë së Republikës së Kosovës. Veprimtaria jonë organizohet dhe zhvillohet në Vrellë, Lipjan, përkatësisht në afërsi të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari".

Aktualisht ASHNA ka 180 nëpunës me pozita dhe funksione të miratuar, kryesisht të organizuara në dy sektorë, operativ dhe administrativ.

Gjatë vitit 2022, ASHNA ka përmbyllur me sukses disa projekte të rëndësishme kapitale, të cilat kanë treguar ndikim të menjëhershëm në ngritjen e sigurisë dhe cilësisë, si për shërbimet tona, ashtu edhe për shfrytëzuesit (kompanitë ajrore, KFOR-in ...)

### 1.1 Misioni

- Ofrimi i sigurtë, efektiv dhe cilësor i shërbimeve të navigacionit ajror
- Normalizimi i plotë i hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës

### 1.2 Vizioni

*ASHNA do të jetë konkurente në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror me efikasitetin më të lartë të kostos në rajon.*

Kjo do të arrihet përmes zhvillimit të vazdueshëm të burimeve njerëzore, moderizimit të infrastrukturës, ngritjes dhe përmirësimit të bashkëpunimit me klientët tanë dhe palët tjera të interesit.



## 2. Objektivat kryesore

Në këtë periudhë që mbulohet nga ky Plan Biznesi, përveç objektivit primar, sigurisë së operimeve, ASHNA synon të arrijë disa objektiva madhore, të cilat do kenë ndikim të theksuar në përmbushjen e misionit dhe vizionit tonë si ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror dhe njëkohësisht do mbështesnin politikat shtetërore për shtrirjen e autoritetit dhe forcimin e sovranitetit në hapësirën ajrore të Kosovës.

1. Normalizimi i hapësirës ajrore
2. Certifikimi me ISO standard 9001:2015
3. Modernizimi i sistemeve për menaxhimin e trafikut ajror
4. Energjia e ripërtitëshme

### 2.1 Normalizimi i Hapësirës Ajrore

#### Hapësira e ulët ajrore/hapja e rrugëve ajrore me vendet fqinje

Normalizimi i hapësirës së ulët ajrore të Kosovës ka filluar që nga viti 2014 dhe nënkupton hapjen e rrugëve ajrore dhe pikave të kordinimit midis Republikës së Kosovës dhe të gjitha vendeve fqinje (Shqipërisë, Malit të Zi dhe Serbisë), që do të shërbenin për të gjithë avionët që fluturojnë në ANP "Adem Jashari" dhe tranzit për aeroportet tjera në rajon. Rrugët e reja ajrore do ta shkurtonin kohën e fluturimit prej 15-30 minuta, zvogëlonin emetimin e gazzrave të dëmshme dhe do të ulnin koston e operimit për kompanitë ajrore.

Synohet që gjatë vitit 2023 të hapen rrugët ajrore me Malin e Zi, gjë që do të implementohet përmes marrëveshjeve teknike - Letter of Agreement (LoA) mes njësive. Deri tani, janë zhvilluar dhe implementuar me sukses projektet për mbulueshmëri me radar, radio, procedura konvencionale instrumentale të fluturimit dhe PBN, si dhe janë realizuar trajnimet e nevojshme për të akomoduar nevojat e këtij objektivi. Gjatë periudhës 2023 - 2026, varësish edhe nga zhvillimet tjera që janë jashtë kapaciteteve tona të kontrollit, synohet hapja e rrugëve ajrore dhe pikave të kordinimit edhe me Serbinë.

#### Hapësira e lartë ajrore/menaxhimi-ofrimi i shërbimeve të navigacionit ajror

Aktualisht, shërbimet e navigacionit ajror në hapësirën e lartë ajrore të Kosovës nga FL 205 deri në FL 660 ofrohen nga Hungarocontrol. Në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës, NATO-n (KFOR) dhe të gjitha palët tjera të interesit, ASHNA synon që deri në vitin 2026 të marr në menaxhim, respektivisht të ofroj shërbime të navigacionit ajror edhe në hapësirën e lartë ajrore. Ky projeksjon për ASHNA-në nënkupton mesatarisht 147.000 fluturime, që mund të krijojnë të hyra vjetore rreth 6-8 million euro.

Përveç kërkeseve dhe aktiviteteve politiko - ligjore, përgaditjet për menaxhimin e hapësirës së lartë ajrore kërkojnë edhe një varg veprime tjera teknike/ investime siç janë;

- Instalimi i një sistemi të ri ATM 2023 - 2026
- Përgaditja e kapaciteve njerëzore, përkatësisht rekrutimi dhe shkollimi i 24 Kontrollorëve të Trafikut Ajror në vitet 2023 - 2026
- Trajnimi i kontrollorëve për "Area Control" (ACC) 2023-2025



## 2.2 Certifikimi me ISO standard 9001:2015

Është synim i ASHNA-së që gjatë vitit 2013 të arrij të certifikohet me ISO 9001:2015, i cili specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë me qellim të;

- a) demonstrimit të aftësive te ASHNA-se për të ofruar vazhdimit Produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e shfrytëzuesve të shërbimeve tona dhe të cilat janë njëkohësisht të aplikueshme statutore dhe rregullatore, dhe
- b) rritjes së kënaqësinë së shfrytëzuesve dhe palëve tjera të interesit, nëpërmjet aplikimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e konformitetit me kërkesat e klientit si dhe ato statutore dhe rregullatore në fuqi.

Duke pasur ne konsideratë rëndësinë që për ne ka Sistemi për Menaxhim të Sigurisë, vlerësojmë se alkimi dhe implementimi i ISO 9001/2015, do të përkrahte gjithashtu edhe SMS -in dhe njëkohësisht do të përmiresonte edhe sistemin e integruar të menaxhimit në ASHNA.

## 2.3 Modernizimi i sistemeve për menaxhimin e trafikut ajror

Për të arritur këtë objektiv të rëndësishëm, i cili ndikon drejtëpërdrejtë në sigurinë dhe zhvillimin e kapaciteteve tona, ne kemi identifikuar nevojën e zhvillimit dhe implementimit të disa sistemeve të reja në periudhën 2023.

- **Sistemi i ri ATM**, do të përkufizohet si projekt kryesor për këtë periudhë pesëvjeçare. Ky sistem/projekt ka ndërlidhje të ngushtë dhe me procesin e normalizimit të hapësirës ajrore.
- **Multilateration (MLAT)**, është sistem i cili mundëson përcjelljen e fluturakeve në hapësirën manovruese në tokë dhe në hapësirën ajrore, në varshmëri nga numri i senzorëve.
- **Aeronautical Message Handling System (AMHS)**, është sistem që mundëson procesim më të avancuar dhe më të sigurt të mesazheve aeronautike.

## 2.4 Energjia e ripërtëritshme

Në funksion të uljes së shpenzimeve të energjisë elektrike dhe njëkohësisht edhe të ruajtjes së ambientit, ASHNA planifikon që brenda këtij viti të filloj kalimin në energjisë së ripërtëritshme. Kjo synohet të arrihet arrihet përmes zhvillimit dhe implementimit të projektit përvendosjen dhe integrimin e panelëve solar. Ky objektiv përkon edhe me objektivat e Qeverisë së Republikës së Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Energji të Ripërtëritshme.



Njësia Organizative: ASHNA  
Nr. Ref. /Kodi: PBV 2023  
Ver.: 1.0  
Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 4 nga 48

### 3. Siguria

ASHNA do të vazhdojë të përqëndrohet në zbatimin e kërkesave të sistemit për menaxhimin e sigurisë. Për më tepër do të vazhdohet puna në përmirësimin e performansës së sigurisë për të përbushur kërkesat ligjore si dhe rekomandimet që rezultojnë nga aktivitetet e ndryshme të sigurisë.

Rritja e nivelit të trafikut, e përcjellë me rritjen e kompleksitetit të operimeve do të paraqesë një sfidë shtesë për menaxhimin e rrjedhës së sigurtë të operimeve.



Njësia Organizative: ASHNA  
Nr. Ref. / Kodi: PBV 2023  
Ver.: 1.0  
Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 5 nga 48

#### 4. Burimet Njerëzore

Përmes hartimit dhe implementimit të planeve për zhvillim dhe trajnim të stafit, ASHNA do ngris kapacitetet e nevojshme për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë që rezultojnë nga vendet e tyre të punës. Gjithashtu përmes politikave zhvillimore, synon ruajtjen e stafit për të ardhmen.

Më Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2022, ASHNA aktualisht ka të aprovuara 180 pozita të punës, ndërsa për vitin 2023, në planin e personelit janë paraparë gjithsej 192 pozita. Stafi i ASHNA-së është i përgaditur dhe i kualifikuar sipas standardeve dhe kriterieve të larta. Sidoqoftë, investime të vazhdueshme janë të nevojshme për të ruajtur nivelin e tyre të kompetencës si dhe për t'i avancuar njohuritë dhe shkathtësitë e tyre në përdorimin e teknologjive dhe procedurave të reja të punës.

ASHNA bërimet njerëzore i sheh si elementin kyç për të mundësuar zbatimin e vizionit të vet për ruajtjen dhe avancimin e sigurisë, me efikasitetin më të lartë të kostos në rajon. Rrjedhimisht, ASHNA e sheh të nevojshme që në aspektin afat-mesëm të punësojë staf shtesë në mënyrë që të jetë në gjendje që të përbushë kërkuesat në rritje që pritet të rezultojnë nga ngritja e vazhdueshme e trafikut në hapësirën e ulët ajrore të Republikës së Kosovës si dhe potencialin përmarrjen nën menaxhim të hapësirës së lartë ajrore të Republikës së Kosovës nga ana e ASHNA-s.

Si rrjedhojë e planit për normalizim të hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2023 është paraparë rekrutimi i 12 Kandidatëve për Student Kontrollor të Trafikut Ajror, ndërsa në vitin 2024 parashihet që numri i personelit nga 192 të rritet në 204, përkatësisht rekrutimin edhe të 12 Kandidateve për Student Kontrollorë të Trafikut.

Rritja e numrit të personelit për vitin 2023 është paraqitur në tabelën në vijim:

Viti	Numri i stafit i planifikuar për rekrutim	Numri total i stafit	Departamentet	Nr i stafit për pozita	Pozitat
2023	12	192	Departamenti i Shërbimeve të Trafikut Ajror	12	Kandidat për Student Kontrollor të Trafikut Ajror




## 5. Strategjia

*Është qëllim strategjik i ASHNA që të optimizojë shfrytëzimin e resurseve të veta në dispozicion për të arritur një performansë të lartë të kost-benefitit*

ASHNA synon të zbatojë strategjinë e saj përmes përqëndrimit në tri fusha kyçë:

- Maksimizimin e performansës së sigurisë;
- Krijimin e një strukture organizative me performansë të lartë;
- Arritjen e performansës së lartë operative dhe biznesore përmes përmirësimit të proceseve të punës.

### Ndërlidhja e komponentëve të strategjisë së ASHNA



## 6. Fushat kyçë Strategjike

Fushat kyçë të paraqitura në vijim dhe rezultatet e tyre shërbejnë për të dhënë inpute me rëndësi në zhvillimin e iniciativave kyçë të ASHNA-së që janë të synuara në arritjen e kërkesave të përcaktuara nga ASHNA. E gjithë kjo arrihet përmes përbushjes së pritjeve të klientëve, përmirësimit të proceseve të punës, dhe vazhdimit të zhvillimit të stafit dhe infrastrukturës.

### Maksimizimi i performansës së sigurisë

- Rritja e besimit të publikut dhe palëve me interes në sigurinë e avacionit.
- Ruajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i sigurisë së operimeve
- Azhurnimi i sistemeve të Menaxhimit të Trafikut Ajror (MTA) dhe teknike duke mos afektuar nivelin e sigurisë

### Krijimi i një strukture organizative me performansë të lartë

- Stafi jonë është i trajnuar dhe aktivisht i angazhuar në procese zhvillimore
- Krijimi i një kulture të përqëndruar në ofrimin kualitativ të shërbimeve
- Ekipe kompetente
- Lidership i fuqishëm dhe efikas

### Performansë e lartë operative dhe biznesore përmes përmirësimit të proceseve të punës

- Kërkesat ligjore kuptohen qartë dhe zbatohen në mënyrë të mirëfilltë si dhe brenda afateve të përcaktuara
- Ngritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve dhe në aspektin biznesor dhe mjedisor
- Përmirësimi i vazhdueshëm bazuar në sistemin për menaxhimin e cilësisë



## Maksimizimi i performansës së sigurisë

Rritja e besimit të publikut dhe palëve me interes në sigurinë e aviacionit.

Ruajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i sigurisë së operimeve

Azhurnimi i sistemeve të MTA dhe teknike duke mos afektuar nivelin e sigurisë

*Siguria dhe integriteti i sistemit të navigimit ajror, së bashku me mirëqenien e stafit tonë janë konsideratat kryesore të ASHNA. Performansa e sigurisë së ASHNA bazohet në ofrimin e shërbimeve të sigurta dhe efikase si dhe në bashkëpunimin me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare për të zvogëluar rrezikun në nivelin më të madh të mundshëm*

Fusha strategjike e maksimizimit të performansës së sigurisë vazhdon të ndërtohet mbi dy tema kyçë të nivelit të lartë;

- zvogëlimi i rrezikut të ndërlidhur me rreziqet kyçë operative dhe të vendit të punës;
- ofrimi i benefiteve të synuara të sigurisë.

ASHNA shprehë zotimin e vet ndaj ngritjes së besimit të klientëve dhe palëve me interes, si dhe arritjes së rezultateve pozitive të sigurisë. ASHNA në mënyrë proaktive përmes zbatimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë do të sigurojë ruajtjen apo përmirësimin e sigurisë së operimeve.

ASHNA do të punojë drejt krijimit të një ambienti të shëndoshë dhe sigurtë të punës për stafin e vet, duke theksuar nevojën për rezultate që tregojnë përmirësimin të vazhdueshëm të kushteve të punës.

ASHNA do të angazhohet në një sërë aktivitetesh dhe forumesh bashkëvepruese të sigurisë në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar me qëllim përfundimtari përmirësuar ndarjen e informatave të sigurisë dhe mësimave të mësuara.



Njësia Organizative: ASHNA  
Nr. Ref. /Kodi: PBV 2023  
Ver.: 1.0  
Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 9 nga 48

## Caqet dhe treguesit kyç të performansës së Sigurisë 2023

Nr	TKP (SPI) për procese	Treguesi i sigurisë	Masat e parapara	Caqet e performansës së sigurisë për vitin 2023
1	Incidentet me ndikim në ATM	Numri i incidenteve me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror (ATM)	Të vetëdijesohet stafi që në mënyrë proaktive të identifikojë hazardet që mund të shpijnë drejt cenimit të sigurisë.	Numri i incidenteve me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 incidente në vitin 2023.
2	Funksioni i Navigimit	Numri i dështimeve të funksionit të Navigimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Me implementimin e projektit për zgjatjen e pistës (Kontrata mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe LKIA për "Zgjatjen e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterrimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari" nr. Identifikues MI-7-024-5.1.5 dhe nr. të kontratës 023/2017 të datës 09.08.2017), janë instaluar sistemet e reja të navigimit dhe rrjedhimisht numri i dështimeve në këtë fushë do të ulet.	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Navigimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 4 dështime në vitin 2023.
3	Funksioni i Survejimit	Numri i dështimeve të funksionit të Survejimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Është në proces implementimi i projektit të radarit të ri në lokacionin e Gjakovës.	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Survejimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 3 dështime apo 80 orë në vitin 2023, përfshi këtu edhe ndërprerjet pëmirëmbajtje të planifikuar
4	Funksioni i Komunikimit	Numri i dështimeve të funksionit të Komunikimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Me implementimin e projektit për zgjatjen e pistës (Kontrata mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe LKIA për "Zgjatjen e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterrimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari" nr. Identifikues MI-7-024-5.1.5 dhe nr. të kontratës 023/2017 të datës 09.08.2017), janë instaluar sistemet e reja të komunikimit (radio, VCS, VCR, ATIS) dhe rrjedhimisht numri i dështimeve në këtë sistem do të ulet. Poashtu është në proces implementimi i projektit të radiove të reja në lokacionin e Gërmisë.	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Komunikimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 dështime në vitin 2023.
5	Funksioni ndihmësi i informimit	Numri i dështimeve të funksionit Ndihmës të informimit duhet të zvogëlohet	Me implementimin e projektit për zgjatjen e pistës (Kontrata mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe LKIA për "Zgjatjen e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterrimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari" nr. Identifikues MI-7-024-5.1.5 dhe nr. të kontratës 023/2017 të datës 09.08.2017), janë instaluar sistemet e reja si AWOS, MESSIR, etj... dhe rrjedhimisht numri i dështimeve në këtë fushë do të ulet.	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të funksionit ndihmës te informimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 20 dështime në vitin 2023.



Njësia Organizative: ASHNA  
 Nr. Ref./Kodi: PBV 2023  
 Ver.: 1.0  
 Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 10 nga 48

Adresa: Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Vrellë, Lypjan, 10070, Republika e Kosovës

6	Funksioni i procesimit tē dhënave	Numri i dështimeve të funksionit procesimit te te dhënavë duhet tē zvogëlohet	Është nē plan prokurimi i sisemit tē ri ATM dhe njëkohësisht është duke u punuar nē përmirësimin e ATM-it ekzistues. Nëse gjithqka shkon sipas planit, ATM i ri pritet tē funksionalizohet brenda 3 viteve. Numri i dështimeve duke pas parasysh gjendjen e sistemit aktual (sistemi i vitit 2004) mund tē jet i lartë	Numri i ndodhive tē dështimit të funksionit të Prosesimit tē tē dhënavë me ndikim nē ofrimin e Shërbimit tē Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet tē mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 30 dështime nē vitin 2023
7	Të tjera	Numri i dështimeve tjera duhet tē zvogëlohet	Janë planifikuar trajnime tē ndryshme profesionale dhe nga aspekti i sigurisë me tē cilat parashihet mes tjerash edhe ndërgjegjësim i personelit nē raport me përgjegjësitë e tyre që ndërlidhen me siguri.	Numri i ndodhive tē dështimit të funksioneve tjera me ndikim nē ofrimin e Shërbimit tē Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet tē mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 nē vitin 2023.

\*Me prokurimin dhe instalimin e sistemeve tē reja, të cilat kanë përfunduar nē vitin 2022, do tē ishte e natyrshme që caqet tē jenë shumë më tē ulëta pēr vitin 2023. Mirëpo, duke pasur parasysh që nevojitet kohë ne adaptimin e faktorit njeri me sistemet e reja, disa prej caqeve i kemi lënë tē pandryshuara dhe do ti analizojmë përgjat vitit 2023. Te funksioni i procesimit tē tē dhënavë kemi paraparë rritje pēr shkak tē vjetërsisë së sistemit. Ndërlidhja e caqeve tē performansës së sigurisë me projektet kapitale është shtjelluar në kapitullin e 12 - Planifikimi i Investimeve Kapitale pēr periudhën 2023-2027.

Njësia Organizative: ASHNA  
 Nr. Ref./Kodi: PBV 2023  
 Ver.: 1.0  
 Data e Ver.: 14.11.2022

Faqë 11 nga 48

Adresa: Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Vreza, Lepaja, 10070, Republika e Kosovës

## Krijimi i një strukture organizative me performansë të lartë

Stafi jonë  
është i  
trajnuar dhe  
aktivisht i  
angazhuar në  
proçese  
zhvillimore

Krijimi i një  
kulture të  
përqëndruar  
në ofrimin  
kualitativ të  
shërbimeve

Ekipet  
kompetente

Lidership i  
fuqishëm dhe  
efikas

*Realizimi i vizionit të ASHNA varet nga stafi, lidershipi dhe kultura organizative e saj. Për të arritur  
këtë, ASHNA vazhdimesht investon në resurset e veta njerëzore*

Investime të vazhdueshme janë të nevojshme për të ruajtur nivelin e kompetencës të stafit si dhe për t'i  
avancuar shkathësitë e tyre. ASHNA në aspektin afatgjatë do të sigurojqë numri i stafit në dispozicion të  
jetë në përputhje me kërkesat operative.

Trajnimet që do të sigurohen nga ASHNA do të janë të synuara për të përmbushur kërkesat ligjore për  
trajnime, si dhe planifikohet që të ndërmerren edhe trajnime shtesë për zhvillimin e burimeve njerëzore.

Iniciativa afatgjata nën këtë fushë theksojnë rëndësinë e ndërtimit të aftësive menaxheriale dhe të  
leadershipit brenda organizatës si dhe zbatimin proaktiv të një sërë iniciativash që janë të përqendruara  
në angazhimin e punonjësve.



Njësia Organizative: ASHNA

Nr. Ref./Kodi: PBV-2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Adresa: Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Vrellë, Lypjan, 10070, Republika e Kosovës

Faqe 12 nga 48

## Performansë e lartë operative dhe biznesore përmes përmirësimit të proceseve të punës

Kërkesat ligjore kuptohen qartë dhe zbatohen në mënyrë të mirëfilltë si dhe brenda afateve të përcaktuara

Ngritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve dhe në aspektin biznesor dhe mjedisor

Përmirësimi i vazhdueshëm bazuar në sistemin për menaxhimin e cilësisë

*Performansa e ASHNA është e përqendruar në përmirësimin e sigurisë, kapacitetit, efikasitetit të kostos dhe ndikimit minimal ndaj mjedisit njëkohësisht duke përmbrushur nevojat e tanishme të klientëve dhe duke krijuar vlerë të shtuar për avionacionin civil. Arritura e prioriteteve të përcaktuara në një mënyrë efikase dhe të parashikueshme është esenciale për qëndrueshmërinë financiare të organizatës.*

Fusha strategjike e performansës së lartë operative dhe biznesore përmes përmirësimit të proceseve të punës thekson zotimin e organizatës për të përmirësuar efikasitetin e ofrimit të shërbimeve brenda organizatës.

Strategjia operative e ASHNA është e përqendruar në ngritjen e nivelit të automatizimit dhe zbatimin e një sërë sistemesh dhe veglash të reja ndaj sistemit për Menaxhimin e Trafikut Ajror të organizatës.

Kjo qasje mundëson përmbrushjen e kërkesave publike dhe ligjore përderisa në të njëjtën kohë përmirëson efikasitetin dhe sigurinë.

Ne gjithashtu duhet të vazhdojmë të bashkëveprojmë me organizatat tjera të fushës së avionacionit civil dhe organizatat tjera relevante në mënyrë që të parashikojë, kuptojë dhe planifikojë nevojat e ardhme përmes shërbimeve dhe teknologjive të reja.



Njësia Organizative: ASHNA  
Nr. Ref. /Kodi: PBV 2023  
Ver.: 1.0  
Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 13 nga 48

## 7. Treguesit e performansës

### Treguesit e performansës

Siguria

Vonesat

Produktiviteti,  
Efikasiteti i Kostos  
dhe Kapaciteti

Matja e kënaqësisë së klientëve dhe palëve me interes shërben përmirësimin e vazhdueshëm të performansës sonë.



Njësia Organizative: ASHNA  
Nr. Ref. / Kodi: PBV 2023  
Ver.: 1.0  
Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 14 nga 48

## 7.1 Siguria

Siguria nënkupton zvogëlimin në maksimumin e mundshëm te rreziqeve që mund të rezultojnë në incidente apo aksidente të aviacionit.

### FUSHA E PERFORMANCE SË SIGURISË

#### Safety KPI #1: Level of Effectiveness of Safety Management

#### Shkalla e Efikasitetit të Menaxhimit të Sigurisë

		2023 Vlera
Objektivat fillestare të performances (Initial Performance Target Setting)	ASHNA (Objektivat e menaxhmentit për kulurën e sigurisë)	C
	ASHNA (për të gjitha objektivat tjera të menaxhmentit)	D
	Përshkrimi i përputhjes së objektivave të ASHNA- së me ato kombëtare	Në nivel të ASHNA-së, objektivat janë në përputhje me ato kombëtare
	Arsyeshmëria e detajuar ne rast të mospërputhjes	

#### Komentet shtesë



Njësia Organizative: ASHNA

Nr. Ref. /Kodi: PBV 2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 15 nga 48

**Safety KPI #2: Aplikimi i shkallës së klasifikimit bazuar në metodologjinë (RAT)**  
**Risk Analyses Tool**

Ground Score	2023 Vlera
--------------	------------

ASHNA (Objektivi I performancës)	SMIs	100%
	RIs	100%
	ATM-S	100%
Përshkrimi i përputhjes së objektivave të ASHNA- së me ato kombëtare	Objektivat e ASHNA-së, janë në përputhje me ato kombëtare	
Arsyeshmëria e detajuar ne rast të mospërputhjes		

Komentet shtesë
Objektivat janë kalkuluar duke konsideruar të dhënrat historike për vitet 2013-2022.



Njësia Organizative: ASHNA  
 Nr. Ref. / Kodi: PBV 2023  
 Ver.: 1.0  
 Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 16 nga 48

## 7.2 Vonesat

Vonesat do të maten nëpërmjet numrit total te fluturimeve te vonuara, minutat totale të vonesës, numrit të vonesave për fluturim ose për fazë të fluturimit, ose kohëzgjatjes mesatare të vonesës për fluturim apo për fluturimin e vonuar, pas vendosjes së një sistemi softuerik gjithëpërfshirës për menaxhimin e trafikut ajror.


### Capacity KPI #2: ASHNA ATFM VONESAT AEROPORTUALE DHE TERMINALE NË ARDHJE PËR FLUTURIM

Niveli kombëtarë	Objektivi fillestari i performancës	2023
		Vlera (min/fluturim)
	Numri i aeroporteve Brenda fushëveprimit të plani të performancës	2.5

	1
--	---

ASHNA	<i>ASHNA - BKPR (Prishtina International Airport)</i>	2.5 (min/fluturim)
	Kontributi i aeroporteve ne planin e perfurmancës	Pasi që ka vetëm një aeroport në Kosovë, kontributi i aeroportit në lidhje me vonesat në nivel kombëtarë është 100%

Komente shtesë	
Për momentin Kosova nuk është pjesë e Menaxhimit të Rrjetit (Network Manager), dhe si rrjedhojë nuk bën pjesë në rregulloren e ATFM për alokim të vendit/sllotit. Për këtë arsy, NSA e Kosovës për momentin nuk pranon të dhëna nga Menaxheri i Rrjetit. Vonesat e fluturimeve për fluturake në aeroport dhe terminal të ANS ATFM definohen si në vijim:	
“Mesatarja e kohës së vonesës së arritjes që i atribuohen shërbimeve për navigim ajror dhe shërbimeve terminale dhe që shkaktohen nga restrikcionet gjatë aterimit në aeroportin e destinimit, definohen si në vijim:	
(i) treguesi është mesatarja e gjeneruar e vonesës nga ATFM vonesa për çdo flutrim IFR;	
(ii) treguesi i mbulon të gjitha fluturimet IFR që aterojnë në aeroportin e destinacionit dhe të gjitha shkaqet e vonesës ATFM, me përjashtim të ngjarjeve të jashtëzakonshme;	
(iii) treguesi llogaritet për tërë vitin kalendarik dhe për çdo vit të periudhës referuese.”	
Për me shumë, treguesi kalkulohet për rrjedhen e fluturimeve hyrëse që arrijnë në aeroport, përfshin një pjesë të vonesës para nisjes e cila shkaktohet nga kufizimet e aterimit në aeroportin e destinimit. Duke patur parasysh definimin e shkruar më lartë, pa të dhëna nga Menaxheri i Rrjetit, është e pamundur të llogaritet historiku i saktë i kësaj mesatareje të KPI.	
Deri më tani, NSA e Kosovës në bashkëpunim me ASHNA-në e Kosovës ka shiquar të dhënat e të kaluarës që ruhen lokalish, të cilat bazohen në alokim vendi/sllot në aeroport procedurë lokale, koha e përafërt e arritjes (ETA) (për të gjitha fluturimet hyrëse) dhe koha e saktë e arritjes. <i>Keni parasysh, alokimi i vendit në</i>	



*aeroport procedurë lokale nuk kryhet në kordinim me menaxherin e Rrjetit.* Si rrjedhojë, dy lloje voneshash tē përsëritura janë kalkular përfshirë fluturimet ateruese:

- 1) në lidhje me alokimin e vendit në aeroport, si diferenca (në minuta) në mes të ATA dhe slotit, dhe
- 2) referuar ETA, si ndryshim (në minuta) mes kohës ATA dhe ETA. Sidoqoftë, shkaku që sllotet nuk janë tē kordinuara, lloji i parë i voneshës rezulton në vlera tē mëdha voneshë përfshirë fluturim. Kjo përfshak që, një voneshë e tillë mbulon voneshën e përgjithshme tē fluturimit që mund tē përfshij: vonesa tē shkaktuara në aeroportin e nisjes, vonesat gjatë rrugës si dhe vonesat në aeroport dhe fazën e fundit.

Lloji i dytë i voneshës rezulton me vlera shumë më të vogla, pasi qe i mbulon vetem vonesat e shkaktuara mes kohës kur fluturimi kordinohet/transferohet mes njesive të ATC'së.

Në mënyrë që tē kemi një vlerë njejtëse tē voneshës, ne kemi zgjedhur tē përdorim një mesatari tē kapshme tē dy llojeve tē voneshës. Shkaku që, siç e përmendem sllotet nuk kordinohen, është mendim i yni që lloji i dytë i voneshës është më i përafert me voneshën reale të ATFM's. Si rrjedhojë ne i kemi caktuar një vlerë prej 20% voneshës së parë dhe 80% voneshës së dytë. Vlera mesatari tē voneshës së 2 viteve tē mëparshme është caktuar si synim përvitin në vijim, pasi që nuk priten zhvillime tē mëdha.

Keni parasysh, pasi që BKPR përmomentin nuk ka limite në kapacitet, ne nuk presim që vonesa mesatari tē shënoj rritje me rritjen e numrit tē trafikut. Duke shiquar tē dhënat e së kaluarës, vonesat mesatari shkaktohen ose janë gjatë sezonit tē dimrit, ne mund tē vijmë në përfundim që shumica e voneshave lokale janë si shkak i motit tē ligë, në veçanti mjegulles së dendur në afërsi dhe rreth aeroportit.

Me instalimin e paisjeve tē reja për aterrim ILS (CAT IIIB pë pistën 17 dhe CAT I për pistën 35), dy sistemeve tē reja AWOS, si dhe me planet përi ri-hapje tē korridoreve tē reja ajrore, ne presim që vonesat mesatari do tē zvogëlohen në vitet tē vijim.

**Vëmendje:** *Kjo pjesë e planit mund tē ndryshojë në vitet tē vijim, nësë Kosova merr tē dhënat direkt nga Menaxheri i Rrjetit.*

### 7.3 Produktiviteti, Efikasiteti i Kostos dhe Kapaciteti

Produktiviteti, Efikasiteti i Kostos dhe Kapaciteti do të matet përmes paraqitjes së të dhënave të ASHNA në raportin vjetor të efikasitetit të Shërbimeve të navigimit ajror.

Për më tepër, tabelat në vijim paraqesin kostot terminale dhe të efektivitetit.

Të dhënat e këtyre tabelave dallojnë nga të dhënat nga tabelat kombëtare (IPP) meqë ende nuk janë të aprovuara.

**Vërejtje:** Tabelat janë të paraqitura në gjuhën angleze.

<i>Kosovo Terminal</i>	2023
Total terminal actual/forecast costs in nominal terms (in national currency)	6,668,725
Inflation %	5.03%
Inflation index (Base = 100 in 2012)	127.71
Total terminal actual/forecast costs in real terms (in national currency at 2012 prices)	4,821,488
Total terminal Service Units (TSU)	12,164
Real terminal UCs (in national currency at 2012 prices)	396.37

**Vërejtje:** Dy prej tabelave janë pjesërisht të plotësuara për arsy se:

në tabelën e parë kërkohet parashikimi i STATFOR për Kosovën, kjo informatë nuk bëhet nga STATFOR, ndërsa në tabelën e dytë kërkohet të bëhet dallimi nga dy burime të informatave për të dhënat aktuale por pasi që është Plan Biznesi ne nuk kemi të dhëna aktuale, kemi vetëm parashikime/projeksione.

<i>Values at 2012 prices</i>	2023
2012 average exchange rate (1EUR=)	1
Total terminal costs in real terms (in €2012 prices)	4,821,488
Trend in total terminal costs in real terms %n/n-1	16.36%
Real terminal UCs (in €2012 prices)	367.37
Trend in real terminal UCs (in €2012 prices) %n/n-1	4.20%
<i>Values at 2009 prices</i>	2023
Inflation index (Base = 100 in 2009)	141.001
2009 average exchange rate (1EUR=)	1
Total terminal costs in real terms (in €2009 prices)	3,934,481
Trend in total terminal costs in real terms %n/n-1	15.01%
Real terminal UCs (in €2009 prices)	299.79
Trend in real terminal UCs (in €2009 prices) %n/n-1	10.72%



### Inflation assumptions

<i>Kosovo Terminal</i>	2023
Inflation %	27.7%
Inflation index (2012=100)	127.71
Eurostat HICP (actuals) and IMF CPI (forecasts)	27.70%
Inflation index (2012=100) HICP and IMF	127.71
Difference in percentage points	
Cumulative difference in percentage points	
Justification and data source in case of deviation from inflation references	

### Service Units forecast for terminal

<i>Kosovo Terminal</i>	2023
Total terminal service units (TSU)	12,164
Year on Year variation TSU	3%
STATFOR terminal service units forecast (Baseline scenario)	
Year on Year variation TSU STATFOR	
Difference in percentage points	
Cumulative difference in percentage points	
STATFOR terminal service units forecast (Low scenario)	
Year on Year variation TSU STATFOR	
Difference in percentage points	
Cumulative difference in percentage points	
Explanation of the differences (if any), justification, rationale and source	



Njësie Organizative: ASHNA  
 Nr. Ref. /Kodi: PBV 2023  
 Ver.: 1.0  
 Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 20 nga 48

## 8. Plani Financiar i ASHNA

Plani strategjik financiar ka për qëllim që të përkrahë zbatimin e objektivave operacionale dhe kapitale të ASHNA-së për periudhën 2023. Plani parasheh zhvillimin afat-gjatë të shërbimeve shtesë për të mundësuar zgjerimin e kapaciteteve infrastrukturore. Për çdo vit fiskal Drejtori i ASHNA-se përgatit propozim-kërkesën për buxhet dhe alokime për ASHNA dhe i dorëzon Ministrit përkatës të Financave. Përgatitjen dhe dorëzimin e dokumenteve të tilla e bënë në pajtim me kërkesat e Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke marr parasysh nivelin e shpenzimeve aktuale dhe të parashikuara si dhe të hyrave të dedikuara të ASHNA-së.

Aktivitetet kryesore për periudhën 2023 do të janë vazhdimi i ofrimit të shërbimeve të navigimit ajror në mënyrë të sigurtë. Në këtë plan vjetor janë paraqitura planifikimi i të ardhurave për mbulimin e shpenzimeve (apo anasjelltas) operative për periudhën 2023 bazuar në nevojat buxhetore të ASHNA-s. Ofrohet e Shërbimeve të Navigimit Ajror rajonal dhe Evropian si dhe në tërë botën në shumicën e rasteve marrin një përqindje të vogël të të hyrave nga hapësira e ulët ajrore, ndërsa shumicën e të hyrave i sigurojnë nga menaxhimi i hapësirës së lartë ajrore. Për arsyet e njohura, ASHNA nuk gjeneron të hyra nga trafiku që mbikalon hapësirën e lartë ajrore të Kosovës dhe kjo situatë vazhdimesh na vendos në pozitë të vështirë.

Gjendja aktuale financiare nënkuption që ka qenë e domosdoshme të eliminohen shumë projekte investive nga parashikimet buxhetore, (të cilat në kushte normale sigurohen nga të gjithë ofrohet e shërbimeve të navigimit ajror rajonal dhe Evropian) siç janë lidhja e kontratave në nivel të shërbimit (Service Level Agreement) me prodhuesit e paisjeve dhe sistemeve tona të aviacionit, mungesa e të cilave në mënyrë të drejtëpërdrejtë mund të afektojë ofrimin e shërbimeve. Plani financiar ka për qëllim që të përkrahë zbatimin e objektivave operacionale dhe kapitale të ASHNA për vitin 2023.

Plani merr parasysh parashikimet e fundit ekonomike dhe krahasuar me planet paraprake, kemi marrë parasysh edhe zhvillimin e shërbimeve shtesë për të mundësuar zgjerimin e kapaciteteve infrastrukturore. Faqet në vijim paraqesin pasqyrat financiare të ASHNA për vitin fiskal 2023.

ASHNA ka planifikuar që të bëjë rekrutimin e stafit të ri si Student Kontrollor të Trafikut Ajror, rekrutim i cili ka një kosto të lartë të shkollimit, andaj edhe në KASH për vitin 2023 janë paraparë shpenzimet për këtë fazë të shkollimit dhe të trajnimit.

### Tarifat e Shfrytëzimit

Tarifat e shfrytëzimit të vlerësuara dhe të mbledhura nga ASHNA do të përfshijnë:

1.1. Tarifat e afritit të vlerësuara për ofrimin e shërbimit të navigacionit ajror brenda hapësirës ajrore të Kosovës; dhe

1.2. Tarifat e mbifluterimit të vlerësuara për avionët që janë të autorizuar për ta shfrytëzuar hapësirën ajrore të Kosovës.

ASHNA do të lejohet vetëm për të vlerësuar dhe mbledhur Tarifat e Afrimit dhe Tarifat e mbifluterimit, kurse rregullimin e tarifave të tilla e bën AAC-ja në përputhje me Ligjin për Aviacionin Civil. ASHNA propozon tarifat e shfrytëzimit për shërbimet e ofruara të navigacionit ajror në mënyrë që tarifat të janë sa më konkurruese me tarifat e ngashme të vendosura nga vendet e tjera në Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit dhe të llogaritura mbi bazën e kthimit të arsyeshëm të shpenzimeve duke marrë parasysh tërë burimet e tjera të të hyrave. AAC shqyrtion dhe miraton tarifat e propozuara nga ASHNA në pajtim me Ligjin për Aviacionin Civil dhe informon Ministrinë për caktimin e tarifave. Tarifat e shfrytëzimit janë obligative për operatorin e avionit. Në qoftë se operatori i avionit është i panjohur, detyrimi për pagesën e tarifës së shfrytëzimit bie mbi pronarin e avionit. Regjimi i tarifave të shfrytëzimit do të përcaktohet me legjislacion për krijimin e një skeme të përbashkët tarifore për shërbimet e navigacionit ajror dhe me ndryshimet/plotësimet e saj. Normat e përcaktuara në këtë mënyrë sigurojnë që të mos ketë diskriminime në mes të shfrytëzuesve të ndryshëm. ASHNA mund të i'a refuzojë ofrimin



Njësia Organizative: ASHNA

Nr. Ref. / Kodi: PBV-2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 21 nga 48

e shërbimeve të navigacionit ajror një shfrytëzuesi të hapësirës ajrore i cili shkel kushtet e pagesës përveç rasteve emergjente të aterimit.

Vërejtje: Tabelat janë të paraqitura në gjuhën angleze

Organisation: Charging zone:	ANSP Kosovo Terminal		Year 2023				
	2020 A	2021 A	2022 A	2023 P	2024 F	2025 F	
Staff	2,756,812	2,854,207	2,899,999	3,529,486	3,887,430	3,906,867	
	0.0%	3.5%	1.6%	21.7%	10.1%	0.5%	
Other operating costs	826,577	1,113,000	1,601,885	2,442,565	2,417,525	2,517,345	
	-44.5%	34.7%	43.9%	52.5%	-1.0%	4.1%	
Depreciation	549,449	549,712	562,061	566,787	605,557	563,082	
	0.3%	0.0%	2.2%	0.9%	8.8%	-7.0%	
Cost of capital	153,695	150,105	158,906	139,886	120,126	100,259	
	-22.3%	-2.3%	5.9%	-12.0%	-14.1%	-16.5%	
Exceptional items							
<b>Total costs</b>	<b>4,286,53 4</b>	<b>4,667,02 5</b>	<b>5,222,852</b>	<b>6,668,72 5</b>	<b>7,030,63 8</b>	<b>7,087,553</b>	
	-16.7%	8.9%	11.9%	27.7%	5.4%	0.8%	
Detail by services (in euro)							
Air traffic management	2,395	2,700	2,820	2,860	3,650	3,441	
	13.5%	12.7%	4.4%	1.4%	27.6%	-5.7%	
Communication	498	521	541	700	540	550	
	8.7%	4.6%	3.8%	29.4%	-22.9%	1.9%	
Navigation	844	898	915	958	1,100	1,300	
	8.9%	6.4%	1.9%	4.7%	14.8%	18.2%	
Surveillance	390	401	446	700	495	546	
	11.1%	2.8%	11.2%	57.0%	-29.3%	10.3%	
Search and rescue	0	0	0	0	0	0	
Aeronautical information	901	925	950	800	645	700	
	0.6%	2.5%	2.7%	-15.8%	-19.4%	8.5%	
Meteorological services	738	786	789	650	600	550	
	15.5%	6.5%	0.4%	-17.6%	-7.7%	-8.3%	
Supervision costs	0	0	0	0	0	0	
Other State costs	0	0	0	0	0	0	
<b>Total costs</b>	<b>4,287</b>	<b>4,667</b>	<b>5,223</b>	<b>6,668</b>	<b>7,030</b>	<b>7,087</b>	
	-16.7%	8.9%	11.9%	27.7%	5.4%	0.8%	



Njësie Organizative: ASHNA

Nr. Ref. /Kodi: PBV-2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022


Faqe 22 nga 48

	2020 A	2021 A	2022 A	2023 P	2024 F	2025 F
<b>Unit rate (in euro)</b>						
Total costs <sup>(1)</sup>	4,286,534 12.11%	4,667,025 8.9%	5,222,852 11.9%	6,668,725 27.7%	7,030,638 5.4%	7,087,553 0.8%
Costs of exempted flights	0	0	0			
Amounts carried over to year (n)	100,308		39,705	138,161		
Income from other sources	250,000	250,000	250,000	350,000	350,000	350,000
Chargeable costs	3,936,226 -18.72%	4,417,025 12.21%	5,012,557 13.48%	6,180,564 23.30%	6,638,407 8.09%	6,737,553 0.85%
Total service units	5,723 -52.27%	11,247 96.52%	11,809 5.00%	12,164 3.00%	12,529 3.00%	12,904 3.00%
Chargeable service units	5,723 -52.27%	11,247 96.52%	11,809 5.00%	12,164 3.00%	12,529 3.00%	12,904 3.00%
Unit rate <sup>(2)</sup>	407.00 7.67%	407.00 0.00%	418.00 2.70%	508.12 21.56%	533.23 4.94%	522.11 -2.09%

2020 A	2021 A	2022 A	2023 P	2024 F	2025 F
-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------

**Unit rate (in euro)**

Exchange rate (1 EUR =)	1	1	1	1	2	3
Unit rate	407.00 7.67%	407.00 0.00%	418.00 2.70%	508.12 21.56%	533.23 4.94%	522.11 -2.09%



Njësia Organizative: ASHNA

Nr. Ref./Kodi: PBV-2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Adresa: Agjencja e Shërbimeve të Navigacionit Ajjor, Vrellë, Lypjan, 10070, Republika e Kosovës

2020 A	2021 A	2022 A	2023 P	2024 F	2025 F
-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------

**Balance to be carried  
over (in euro)**

Charges billed to users	2,329,261 -51.90%	4,577,529 96.52%	5,012,557 9.50%	6,180,564 23.30%	6,680,638 8.09%	6,737,553 0.85%
Actual total costs	4,286,534 -16.66%	4,667,025 8.88%	5,222,852 11.91%	6,668,725 27.68%	7,030,938 5.43%	7,087,553 0.81%
Income from other sources	2,048,161	228,000	250,000	350,000	350,000	350,000
Actual costs of exempted flights						
Amounts carried over to year (n)	103,000	138,161	127,159	138,161		
<b>Balance of year (n)</b>	<b>193,888</b>	<b>-343</b>	<b>87,454</b>	<b>276,322</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

**Metodologjia dhe parimet e tarifimit**

Llogaritja e tarifës njësi për tarifën terminale të navigacionit (TNC) për vitin 2023 ka rezultuar nga zbatimi i metodologjisë së përcaktuar në Rregulloren nr. 3/2016 të AAC-së mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror. Bazuar në këtë metodologji, TNC llogaritet përvitin "n" në bazë të kostove dhe trafikut të vlerësuar për atë vit. Do të zbatohet një mekanizëm i rregullimit përfundimtar i shërbimit përcaktohet duke mbuluar të gjitha kostot për shërbimet e ofruara (kontrolli i trafikut ajror, navigacioni dhe vëzhgimi, informatat aeronautike dhe meteorologjia) duke ia shtuar kësaj kthimin e arsyeshëm në investimet e bëra për t'i ofruar këto shërbimeve.

Parimi bazë i kësaj metodologje është që tarifat e rregulluara, siç është TNC, do të mbulojnë të gjitha kostot e shkaktuara nga ASHNA, ato operative dhe kapitale, të nevojshme përfundimtar i shërbimit përcaktohet duke mbuluar të gjitha kostot për shërbimet e ofruara (kontrolli i trafikut ajror, navigacioni dhe vëzhgimi, informatat aeronautike dhe meteorologjia) duke ia shtuar kësaj kthimin e arsyeshëm në investimet e bëra për t'i ofruar këto shërbimeve.

**Kostot e pranueshme**

Në bazë të Rregullores nr. 3/2016, ASHNA përcakton kostot e shkaktuara nga ofrimi i shërbimeve të navigacionit ajror në lidhje me objektet dhe shërbimet e ofruara. Këto kosto ndahen në:

- Kosto e stafit (pagesa bruto, pagesa përpunë jashtë orarit, kontributi i punëdhënësit për skemën pensionale, si dhe kostot e pensioneve dhe përfitimeve tjera);



- Kosto operative (blerja e mallrave dhe shërbimeve për të ofruar shërbime të tilla si komunikimi, konsulentët, materiale, energjia, shërbimet komunale, qiraja, pajisjet e objekteve, mirëmbajtja, kostot e sigurimit dhe të udhëtimit);
- Kosto e zhvlerësimit (që lidhen me asetet fikse në funksion për qëllime të ASHNA-s);
- Kosto e kapitalit (produkti i: a) shumës së vlerës mesatare neto të regjistruar në libra të aseteve fikse në funksion apo në ndërtim e sipër të përdorura nga ASHNA dhe të vlerës mesatare të aseteve afatshkurtra të nevojshme për ofrimin e shërbimeve dhe b) mesatarja e ponderuar e normës së interesit mbi borxhet dhe të kthimit nga kapitali);
- Artikujt e veçantë (kostot jo-periodike në lidhje me ofrimin e shërbimeve).

### Llogaritja e tarifës terminale

Tarifa terminale për një fluturim specifik sipas Shtojcës V të Rregullores është e barabartë me produktin e tarifës njësi të vendosur për këtë zonë të tarifimit terminal dhe njësive të shërbimeve terminale për këtë fluturim. Njësitë e shërbimeve terminale (TSU) llogariten në bazë të formulës:

$$TSU = (MTOW/50)^{0.7}$$

#### Paraqitura e kostove të stafit dhe atyre operative

Në linjën e kostove të stafit dhe operative janë përfshirë vetëm kostot e pranueshme për stafin dhe kostot operative siç përshkuhen në nenin 5 më sipër.

Për komponentin e dytë të raportimit në të cilin paraqiten kostot tjera operative janë përfshirë vetëm shpenzimet e domosdoshme në mënyrë që ASHNA të mund të japë shërbime me standarde të kërkua të sigurisë.

Pjesa më e madhe e kostove tjera operative është planifikuar për mirëmbajtjen e paisjeve e cila është jetike për ASHNA si dhe trajnimet e domosdoshme për të mbajtur dhe për të ngritur nivelin e kompetencës në vendet e punës për personelin e ASHNA.

#### Vlerësimi dhe përcaktimi i zhvlerësimit dhe kostojës e kapitalit

##### Baza e aseteve

Në listën e aseteve që ASHNA ka shfytëzuar për llogaritjen e kostos së zhvlerësimit dhe të kaiptalit është siguruar që të përfshihen vetëm ato asete që janë në funksion, që akoma nuk janë zhvlerësuar plotësisht dhe që janë duke u përdorur për qëllim të ofrimit të shërbimeve për përdoruesit. Gjithashtu janë rigrupuar asetet në pesë kategori kryesore, është vlerësuar periudha e zhvlerësimit, e cila është përdorur, dhe ka arritur në vlerën korresponduese të bazës së aseteve.

##### Zhvlerësimi

ASHNA ka paraparë jetëgjatësinë e paisjeve 15 vjet në bazë të shembullit nga Manuali i ICAO-s për Ekonominë e SHNA-së ndërsa sa i përket pajisjeve pasurive tjera kostot historike dhe metoda lineare për zhvlerësim janë përdorur në përputhje me Rregullorën e aplikueshme.

##### Kostoja e kapitalit

Në pajtim me Rregulloren, kostojës e kapitalit është e barabartë me produktin e kapitalit të shfytëzuar dhe koston mesatare të ponderuar të kapitalit (WACC). Bazuar në Manualin e ICAO-s 9161 për

Njësia Organizative: ASHNA

Nr. Ref. / Kodi: PBV-2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Paqe 25 nga 48

Ekonominë e SHNA-së, kostoja e kapitalit është llogaritur në baza vjetore për tërë kapitalin e investuar në asete fikse, apo shpenzime tjera, të cilat duhet të shlyhen me kalimin e kohës, dhe në kapitalin punues.

Për të llogaritur kapitalin e shfrytëzuar me qëllim të përcaktimit të kostos së kapitalit, është përdorur formula e mëposhtme:

$$\text{Kapitali i shfrytëzuar} = \text{vlera mesatare e (aseteve fikse neto + investimet e reja) + asetet aktuale neto (kapitali punues)}$$

Vlera mesatare e aseteve fikse neto dhe investimet e reja tashmë janë identifikuar gjatë llogaritjes së kostove të zhvlerësimit, ndërsa kapitali punues është përcaktuar në bazë të ndryshimit ndërmjet aseteve aktuale dhe pasiveve aktuale, siç theksohet në pasqyrat financiare.

Bazuar në Udhëzimin e EUROCONTROL-it mbi tarifat e rrugëve ajrore: "Kostoja e duhur mesatare e ponderuar e kapitalit (WACC) që do të përdoret është një çështje që Shteti (ose rregullatori tjetër kombëtar ekonomik) duhet ta aprovojë, duke marrë parasysh rrezikun e ulët financier të ofrimit të shërbimeve të navigacionit ajror. Norma e bonove qeveritare, ose ndryshe normat e pagueshme në tregjet financiare nga ndërmarrjet me rrezik ngjashëm të ulët, mund të merren si udhëzues." Formula për llogaritjen e WACC është si më poshtë:

$$WACC = Kthimi i kapitalit \times \frac{\text{Kapitali}}{\text{Borxhi} + \text{Kapitali}} + Kthimi i borxhit \times \frac{\text{Borxhi}}{\text{Borxhi} + \text{Kapitali}}$$

ASHNA aktualisht nuk bartë ndonjë borxh afatgjatë dhe për këtë arsy e kthimi i borxhit nuk i kontribuon ekuacionit të mësipërm. Prandaj, ka mbetur të përcaktohet vetëm kthimi i kapitalit.

Republika e Kosovës nuk ka treg të kapitalit, për këtë arsy është i vështirë përcaktimi i normës së kthimit sipas tregut.

ASHNA propozon kosto të kapitalit të llogaritur duke përdorur normën mesatare të interesit të kthimit për rrezik afatgjatë që është 3.4%. Kjo është gjithashtu në përputhje me normat e kthimit të përdorura nga vendet fqinje, OSHNA-t e të cilave konsiderohen të kenë po të njëjtin rrezik financier.


Më poshtë është dhënë vlerësimi dhe përcaktimi i kostos së kapitalit për asetet ekzistuese, pasiqë planifikohet që investimet për asetet e reja të bëhet nga grantet qeveritare dhe nuk do të ketë kosto të kapitalit të ngarkuar në tarifa për to.

### Kostoja e kapitalit të aseteve

Kostoja e kapitalit të aseteve ekzistuese është llogaritur duke shumëzuar  $WACC = 3.4\%$  me vlerën mesatare neto të aseteve ekzistuese duke ia shtuar edhe kapitalin punues. Siç u shpjegua më lart, kapitali punues është i barabartë me ndryshimin ndërmjet aktivës dhe pasivës aktuale.

### Parashikimi i trafikut

Numri i TSU-ve është parshikuar në bazë të rritjës historike të tyre përgjatë viteve paraprake, si dhe duke u bazuar në rritjen e periudhes se fundit te vitit 2022. TSU janë llogaritur me formulën  $TSU = (MTOW/50)^{0.7}$



## Supozimet e trafikut

Rritja e trafikut në ANP nuk tregon një korrelacion të fortë me rritjen e BPV-së, prandaj nuk është marrë për bazë për qëllim të parashikimit. Në të njëjtën kohë, ASHNA ka qasje në të dhënat historike të TSU-së me qëllim të parashikimit, duke filluar vetëm nga viti 2014. STATFOR nuk mund të përdoret për qëllimin e parashikimit. Prandaj, të dhënat historike për numrat e fluturimit janë marrë në konsideratë për qëllimin e parashikimit. Një ngjarje kryesore që pritet gjatë periudhës së ardhshme është normalizimi i hapësirës së ulët ajrore e cila do të rrissë Trafikun e Përgjithshëm të Avionit brenda vendit dhe do të rrissë fluturimet me qëllim të uljes në aeroportet e vendeve fqinje.

### 8.1 Pasqyra e të ardhurave

AGJENCIA PËR SHËRBIMET E NAVIGACIONIT AJROR PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETI 2023-2025 (në Euro)				
Nr	PERSHKRIMI	Buxhetit 2023	Buxhetit 2024	Buxhetit 2025
A	B	C	D	E
<b>Te Ardhurat</b>				
1	Te hyra nga approach fee	6,318,725	6,680,638	6,737,553
2	Te hyra nga sherbimet e radarit Hungarocontrol	350,000	350,000	350,000
3	Granti Qeveritar			
	<b>Gjithsej te Ardhura</b>	<b>6,668,725</b>	<b>7,030,638</b>	<b>7,087,553</b>
<b>Shpenzimet</b>				
1	Pagat dhe meditjet	-3,529,486	-3,887,430	-3,906,866
2	Shpenzimet e udhetimit	-223,000	-252,000	-230,000
3	Sherbimet per telekomunikacion	-94,500	-94,500	-94,500
4	Shpenzimet per sherbimet	-1,054,565	-1,064,525	-777,845
5	Mobile dhe paisje me vlerë <1000 Euro	-12,000	-10,000	-11,000
6	Blerje tjera te mallrave dhe sherbimeve	-43,500	-34,000	-45,000
7	Derivatet dhe lendet djegese	-42,000	-42,000	-43,000
8	Sherbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	-184,000	-184,000	-189,000
9	Mirembajtja	-642,000	-587,000	-977,500
10	Shpenzimet e marketingut	-12,500	-12,500	-12,500
11	Shpenzimet e perfaqësimit	-15,000	-15,000	-15,000
12	Llogaritë e Avanseve-P/Cash			
13	Shpenzimet e komunalive	-119,500	-122,000	-122,000
	<b>Gjithsej Shpenzime</b>	<b>-5,972,051</b>	<b>-6,304,955</b>	<b>-6,424,211</b>
	<b>Te Ardhurat - Shpenzimet</b>	<b>694,674</b>	<b>725,683</b>	<b>663,342</b>
1	Amortizimi	-566,787	-605,557	563,082
2	Kostoja e Kapitalit	-139,716	-120,126	-100,260
	<b>Fitimi/Humbja Neto</b>	<b>-9,829</b>	<b>0</b>	<b>0</b>



## 9. Analiza e planit finanziar

### 9.1 Të hyrat

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), të hyrat e ASHNA-së do të përbëhen nga:

1. Tarifat e shfrytëzuesve të vlerësuara dhe të mbledhura nga ASHNA; dhe
  2. Donacionet, grantet dhe çdo mbështetje tjetër financiare ose teknike e dedikuar për ASHNA.
- 
1. Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës, të hyrat e dedikuara të Agjencive të pavarura.
  2. Të gjitha të hyrat e dedikuara duhet të depozitoohen nga agjencitë e pavarura në Fondin e Kosovës dhe regjistrohen në SIMFK në pajtim me Rregullat Financiare të Thesarit. Të gjitha agjencitë e pavarura duhet të dorëzojnë planin e rrjedhës së parasë së gatshme në Thesar.
  3. Të gjitha të hyrat e dedikuara ndahen për secilën agjenci të pavarur sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi. Buxheti i Republikës së Kosovës përfshin të gjitha të hyrat e dedikuara ashtu si pranohen gjatë qdo vitit fiskal.
  4. Tërë bilanci i paspenzuar i të hyrave të dedikuara nga viti paraprak fiskal ndahet dhe autorizohet për vitin fiskal pasues për agjencitë e pavarura sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, me kusht që shuma maksimale e të Hyrave të Dedikuara e cila ndahet përmes këtij ligji nuk duhet të tejkalojë shumën e specifikuar në tabelat buxhetore të këtij ligji dhe pjesa e mbetur më nuk mund të konsiderohet si e Hyrë e Dedikuar.
  5. Shuma e të hyrave të dedikuara të ndara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij nenit nuk duhet të kalojë ndarjen maksimale për agjencitë e pavarura të specifikuar në ligjin e buxhetit.
  6. Nëse gjatë vitit fiskal nuk ka mjete të mjaftueshme të mbledhura dhe në dispozicion, sipas paragrafëve 2 dhe 3 të këtij nenit, për të plotësuar kërkesat e përcaktuara në planin e rrjedhës së parasë së gatshme të dorëzuar në Thesar-Ministria e Financave, fondet e tjera publike nga Fondi i Kosovës autorizohen në këtë mënyrë për tu ndarë në një shumë të mjaftueshme për të plotësuar deficitin. Gjatë tërë kohës, të hyrat e dedikuara duhet të përdoren si burim financimi me prioritet të parë për pagesat e Shpenzimeve të Agjencisë së pavarur para se të ndahan dhe përdoren burimet tjera të financimit. Ministri, së paku dy herë në vit, gjatë rishikimit buxhetor dhe në Raportin Financiar, i raporton Komisionit për Buxhet dhe Financa nëse fondet kanë qenë të mjaftueshme dhe cilat masa janë marrë që fondet e duhura të janë në dispozicion.
  7. Përderisa pranohen dhe ndahen të hyrat e dedikuara për vitin fiskal buxhetor ato do të zëvendësojnë të tërë ndarjet dhe financimet e bëra sipas paragrafit 5 të këtij nenit në atë nivel që financimi i deficitit nga Fondi i Kosovës të mos jetë shpenzuar ende.
  8. Pavarësisht nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij nenit, Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror në pajtim me Ligjin Nr.04/L-250 për Agjencinë për Shërbimet e Navigacionit Ajror do të financohet tërësisht nga të hyrat e dedikuara dhe të depozituara në Fondin e Kosovës sipas tabelave me këtë ligj(buxhetit). Fondet e mbetur nga të hyrat e dedikuara e të paspenzuara nga viti paraprak vazhdojnë të trajtohen si të hyra të dedikuara për financim të Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror, për vitet vijuese.
  9. Të gjitha mjetet e pasfrytëzuara deri më 31 Dhjetor të çdo vitit fiskal Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror nga llogaria e tanishme i bartë në Fondin e Kosovës, në llogarinë zyrtare të hapur nga Thesari, Ministria e Financave për këtë Agjenci.

Në këtë plan të biznesit jemi bazuar në të hyrat e kufizuara të cilat sigurohen vetëm nga tarifa e aterimit (Approach Fee) dhe një përqindje të vogël të të hyrave tjera të cilat parashikohet të mbulojnë vetëm

Njësia Organizative: ASHNA

Nr. Ref. /Kodi: PBV-2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Faqë 28 nga 48

shpenzimet më esenciale operative. Për pjesën të cilën nuk mund ta mbulojmë nga të hyrat tona do të drejtohem i tek institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës pasi siç dihet mirëfilli asnjë Ofrues i Sherbimeve të Navigimit Ajror ne rajon apo edhe më gjërë nuk mund ti mbuloj shpenzimet vetem nga tarifa e aterimit por ato mbulohen nga hapësira e lartë ajrore e cila për një periudhe kalimtare i është deleguar për menaxhim shtetit të Hungarisë apo më saktësisht HungaroControl-it nga NATO. Poashtu edhe për projektet e paraqitura kapitale jemi bazuar në përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës të zotuara me aprovimin e ligjit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigimit Ajror.

## 9.2 Shpenzimet

Në këtë plan vjetor të biznesit kemi paraqitur shpenzimet e projektuara pas marrjes së inputeve nga tërë struktura Menaxheriale e ASHNA-se për vitin 2023 dhe vlerësimet 2024 & 2025.

Gjatë përpilimit të këtij plani vjetor jemi mbështetur në dy parime bazë:

Vazhdimi i ofrimit të shërbimeve të navigimit ajror në hapësirën e ulët ajrore të Republikës së Kosovës; Zhvillimi i infrastrukturës ajrore për të përm bushur nevojat e ardhme operative (në rast të sigurimit të hyrave shtesë)

Shpenzimet e propozuara në këtë plan përfaqësojnë minimumin absolut të shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror në hapësiren e ulët të Republikës së Kosovës, ku më poshtë do të shpalosim të gjitha shpenzimet.

Tabela me shënimë shpjeguese kategoria Paga dhe mëditje

Nr	Përshkrimi	Buxheti 2022	Vlerësimet 2023	Vlerësimet 2024	Vlerësimet 2025
1	PAGAT DHE SHTESA	2,798,003 €	€ 3,529,486.00	€ 3,887,429.70	€ 3,906,866.14

## Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit-gra	Numri total i stafit-burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2022	164	29	135	415430	2071990
2023	192				
Planifikimi për 2023	192				



Përshkrimi	Kodet: Free balance	DEP.	Vleresimet 2022	Vleresimet 2023	Vleresimet 2024	Vleresimet 2025
<b>Vleresimet - Shpenzimet operative - Totali</b>			<b>4,399,888.00</b>	<b>5,972,051.40</b>	<b>6,304,954.70</b>	<b>6,424,211.86</b>
PAGAT DHE Totali	11100		2,798,003	3,529,486.40	3,887,429.70	3,906,866.86
Paga e rregullt bruto	11110	DBNJ	2,453,880	3,121,401	3,456,401	3,470,801
Pagesat për punë jashtë orarit, shtesat, stimul.	11200	DBNJ	210,885	240,015	245,913	250,025
Kontributi për pension i punëdhënësit	11140	DBNJ	133,238	168,071	185,116	186,041
MALRRAT DHE SHERBIMET	13000		1,489,515	2,323,065	2,295,525	2,395,345
<b>Shpenzimet e udhetimit</b>	<b>13100</b>		<b>217,750</b>	<b>223,000</b>	<b>252,000</b>	<b>230,000</b>
Biletat e Udhëtimeve jashtë vendit	13140	DADM	64,000	60,000	65,000	70,000
Meditjet e udhetimit zyrtar jashtë vendit	13141	DBNJ	64,750	70,000	80,000	70,000
Akomodimi për udhetim zyrtar jashtë vendit	13142	DBNJ	79,000	80,000	90,000	80,000
Shpenzime tjera të udhetimit zyrtar jashtë vendit	13143	DBNJ	10,000	13,000	17,000	10,000
<b>Sherbimet e telekomunikimit</b>	<b>13300</b>		<b>54,500</b>	<b>94,500</b>	<b>94,500</b>	<b>94,500</b>
Shërbime postare	13330	DADM	1,500	1,000	1,000	1,000
Shërbime postare-të jashtme	13330	DADM	1,500	1,000	1,000	1,000
Internet	13310	DTEK	1,000	1,000	1,000	1,000
Linja e dedikuar optike me Golesh, Gërmë, Gjakovë, Shkup, Tiranë	13340	DTEK	40,000	80,000	80,000	80,000
Telefonia mobile	13320	DADM	10,500	11,500	11,500	11,500
<b>Shpenzimet për shërbimet</b>	<b>13400</b>		<b>564,297</b>	<b>1,054,565</b>	<b>1,064,525</b>	<b>777,845</b>
Shërbime DDD	13460	DADM	1,200	1,500	1,500	1,500
Shpedicion	13460	DADM	1,000	1,000	1,000	1,000
R&D	13460	ZYDR				
Qeraja në Gërmë	13460	DTEK	1,680	1,680	1,680	

Shërbime konsulente, Certifikim me ISO standard	13460	DCSS	12,500	10,000	10,000	10,000
Librari (Libra, Harta, Publikime Periodike), shirita, position log	13450	DADM	4,800	5,500	5,500	5,500
Komision i auditimit	13460	ZYDR	1,920	1,920	1,920	1,920
Sistemi AFTN - mirëmbajtje (SLA)	13450	DTEK		35,000	35,000	35,000
AFTN lidhja-ISA VIA	13460	DTEK	39,732	45,000	45,000	45,000
Shërbime të veganta	13460	DBNJ	15,000	25,000	25,000	25,000
Shërbime konsulente për Sistemin e Menaxhimit të Trafikut Ajror dhe AIM	13460	DATS	55,040	55,040	60,000	60,000
Shërbime dizajnimi / projektimi i katit të dyte të ndërtesës (dhe tjera sipas nevojës)	13460	DADM		5,000	5,000	5,000
Antarësimi në CANSO	13480	ZYDR	12,925	12,925	12,925	12,925
Trajnime	13410	DZHT	349,000	720,000	720,000	430,000
Konferenca	13410	ZYDR	20,000	10,000	10,000	10,000
Licenca për staf (mjekësore, profesionale) dhe Stafi	13430	DZHT	8,500	90,000	95,000	100,000
Liceca vjetore EUMETSAT	13470	DTEK	4,000	4,000	4,000	4,000
Licencimi i frekuencave nga ARKEP	13470	DTEK	4,500	6,000	6,000	6,000
Tarifa e AACK lidhur me Mbikëqyrjen e Sigurisë	13470	DCSS	5,000	5,000	5,000	5,000
Tarifa e AACK lidhur me Aprovimin e ndryshimeve të mëdha	13470	DCSS	27,500	20,000	20,000	20,000
Blerja e mobiljeve dhe pajisje me më pak se 1000 Euro	13500		10,200	12,000	10,000	11,000
Paisje për zyre	13509	DADM	5,100	7,000	5,000	5,500
Paisje sigurimi-kamera	13509	DTEK	5,100	5,000	5,000	5,500
Blerjet tjera të mallrave dhe shërbimeve	13600		30,300	43,500	34,000	45,000
Furnizim për bife dhe ujë të pijes	13620	DADM	5,000	10,500	10,500	11,000
Material higjenik për pastrim	13640	DADM	8,100	9,500	9,500	10,000
Material harxhues për zyrë	13610	DADM	7,000	8,000	8,000	8,500

Njësia Organizative: ASHNA

Nr. Ref. / Kodi: PBV-2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 31 nga 48

Festime, Kremlime, Ceremoni ...	13620	ZYDR	5,500	6,000	6,000	6,000
Veshëmbathje për stafin operativ të Sigurim & Teknik (veshje për teren)	13650	DADM	4,700	9,500	-	9,500
Derivatet dhe lëndët djegëse	13700		25,100	42,000	42,000	43,000
Diesel	13780	DADM	13,500	26,500	26,500	26,500
Furnizim derivate për Gjenerator	13770	DADM	5,000	9,000	9,000	10,000
Furnizim me vaj (Vetura, Gjenerator dhe Radar)	13710	DADM	6,600	6,500	6,500	6,500
Llogaritë e avacit	13800					
Shpenzim i parasë së imët	13810	DFIN				
Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	13901		131,500	184,000	184,000	189,000
Sigurimi dhe kontrolla teknike e automjeteve	13951	DADM	5,000	5,000	5,000	5,000
Taksa komunale për regjistrimin e automjeteve	13952	DADM	1,000	1,000	1,000	1,000
Sigurimi i Aseteve	13953	DADM	11,000	15,000	15,000	20,000
Sigurimi i operimeve	13953	DADM	111,500	160,000	160,000	160,000
Regjistrimi i automjeteve	13950	DADM	3,000	3,000	3,000	3,000
Mirëmbajtja	14000		439,768	642,000	587,000	977,500
Mirëmbajtja e automjeteve	14010	DADM	6,100	9,500	9,500	9,500
Pastrimi i veturave dhe ndërrimi i gomave	14010	DADM	2,300	3,500	3,500	3,500
BMS (Mirëmbajtja e Ujësjellësit, rrjetit elektrik, riparimi i ndërtesave, klimave, mjete të punës)	14020	DTEK	15,000	41,000	41,000	41,000
Mirembajtja e UPS-ave	14040	DTEK	20,000	8,000	8,000	8,000
Strukturimi i kabllimit& pjese rezerve per servera dhe rrjete.	14040	DTEK	5,568	5,000	5,000	5,000
Mirembajtja e softuereve te IPD	14040	DTEK	1,300	4,500	4,500	4,500
Mirëmbajtja e paisjeve të zjarrfikësve dhe sistemi i zjarrfikjes-BMS	14050	DTEK	6,000	6,000	6,000	6,000
Mirëmbajtja e gjeneratorëve	14050	DTEK	7,500	12,000	12,000	12,000

Kalibrimi i paisjeve të navigimit	14050	DTEK	41,500	70,000	70,000	70,000
Mirëmbajtje e sistemit të navigimit, SLA	14050	DTEK	30,000	10,000	10,000	60,000
Mirëmbajtje e sistemit VHF dhe UHF primar dhe back up	14050	DTEK		25,000	-	125,000
Mirëmbajtje e sistemit VCR, sistemi i ri	14050	DTEK				30,000
Mirëmbajtje e sistemit VCSS	14050	DTEK	50,000	70,000	70,000	140,000
Mirëmbajtje e multipleksërve në ASHNA dhe Golesh	14050	DTEK		5,000	-	5,000
Mirëmbajtje e sistemit PABX	14050	DTEK		20,000	-	-
Mirëmbajtje e sistemit të survejimit	14050	DTEK		150,000	150,000	150,000
Mirëmbajtje gjenerale e radarit MSSR/PSR Mode S (mekanike dhe elektronike, RJ3CH)	14050	DTEK	168,000	150,000	150,000	150,000
Linja dytësore PSR/MSSR Mode M - ASHNA	14050	DTEK		5,000	5,000	-
Mirëmbajtja e sistemit të parashikimit të motit	14050	DTEK		-	-	30,000
Mirëmbajtja e sistemit ATIS - DTN	14050	DTEK		-		30,000
Mirëmbajtja e sistemit përkomunikim Tokë - Tokë	14050	DTEK		5,000	-	5,000
Mirëmbajtja e liftit	14050	DTEK	2,000	7,000	7,000	7,000
Mirëmbajtje e sistemit të kamerave	14050	DTEK	3,000	8,000	8,000	8,000
EAD-data user	14050	DAIS	6,000	-	-	-
Paisje testuese, senzor meteorologjik dhe kalibrimi i tyre	14050	DTEK	69,500	15,000	15,000	15,000
Mirëmbajtja e Sistemeve RADAR-ike (SLA) dhe ATM	14050	DTEK				
Pastrimi i objektit	14060	DADM	5,000	10,000	10,000	10,000
Mirëmbajtja e sistemit AWOS	14050	DTEK		-	-	50,000
Gjelbërim përrreth ndërtësës	14060	DADM	1,000	2,500	2,500	3,000
Shpenzimet e marketingut	14200		11,100	12,500	12,500	12,500
Publikime	14220	ZYDR	5,100	5,000	5,000	5,000

Njësia Organizative: ASHNA

Nr. Ref. /Kodi: PBV-2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Faqë 33 nga 48

Gazeta dhe anëtarësime ne WEB	14230	ZYDR	1,800	3,000	3,000	3,000
Material promovues	14210	ZYDR	4,200	4,500	4,500	4,500
Shpenzimet e Përfaqësimit- Reprezentacionit	14300		5,000	15,000	15,000	15,000
Reprezentacion	14310	ZYDR	5,000	15,000	15,000	15,000
Vendime gjyqësore	14410					
SHPENZIMET E KOMUNALIVE	13200		112,370	119,500	122,000	122,000
Largimi i mbeturinave	13230	DADM	1,500	1,500	2,000	2,000
Energji elektrike e harxhuar	13210	DADM	88,000	90,000	92,000	92,000
Telefonia fikse	13250	DADM	6,500	6,500	6,500	6,500
Ujë	13220	DADM	1,000	1,500	1,500	1,500
Ngrohja	13240	DADM	15,370	20,000	20,000	20,000
Vlerësimet - Shpenzimet operative						
<b>Totali</b>			<b>4,399,888.00</b>	<b>5,972,051.40</b>	<b>6,304,954.70</b>	<b>6,424,211.86</b>

Njësia Organizative: ASHNA

Nr. Ref. /Kodi: PBV-2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 34 nga 48.

**Tabela me shënime shpjeguese kategoria Mallra dhe Shërbime**

Nr	Kufijtë buxhetor 2023 MF	Kërkesa 2023 ASHNA
1	1,650,000	2,323,065

Ndryshimi në mes të kufijve fillestare dhe kérkesës sonë buxhetore është se duke pasur parasysh nevojën dhe arritjen e prioriteteve të organizatës sonë buxhetore si dhe arritjes së objektivave. Planifikimi te kjo kategori është e bazuar në kérkesat e njësive shpenzuese-Departamenteve të ASHNA-se të cilat kanë prioritizu kérkesat dhe nevojat e tyre për funksionalizimin dhe arritjen e objektivave sipas planeve vjetore të punës përbrenda organizatës buxhetore.

Nr.	Përshkrimi	Buxheti 2022	Kërkesa 2023	Vlerësimet 2024	Vlerësimet 2025
1	<b>MALLRAT DHE SHËRBIMET</b>	<b>1,489,515</b>	<b>2,323,065</b>	<b>2,295,525</b>	<b>2,395,345</b>
	Shpenzimet e udhetimit	217,750	223,000	252,000	230,000
	Shërbimet e telekomunikimit	54,500	94,500	94,500	94,500
	Shpenzimet për shërbimet	566,365	1,054,565	1,064,525	777,845
	Blerja e mobiljeve dhe pajisj. Me më pak 1000 euro	10,200	12,000	10,000	11,000
	Blerjet tjera të mallrave dhe shërbimeve	30,300	43,500	34,000	45,000
	Derivatet dhe lëndët djegëse	25,100	42,000	42,000	43,000
	Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	131,500	184,000	184,000	189,000
	Mirëmbajtja	437,700	642,000	587,000	977,500
	Shpenzimet e marketingut	11,100	12,500	12,500	12,500
	Shpenzimet e përfaqësimit-reprezentacionit	5,000	15,000	15,000	15,000



### **Shpenzimet e udhëtimit**

Shpenzimet e planifikuara te linja për udhëtime zyrtare për vitin 2023 dhe 2024-2025 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror janë kryesisht shpenzime jashtë vendit. Ato janë të bazuara në kërkesat dhe nevojat e Departamenteve që brenda vitit buxhetor t'i shpenzojnë për udhëtime zyrtare, të cilat kanë karakter trajnimi, shkollimi, prezantimi, promovimi, aftësimi dhe shkëmbimi të përvojave si dhe pjesmarrje në konferenca të ndryshme rjonale dhe botërore të avionit për nevojat ASHNA-së. Gjithashtu, masa e mjeteve për këtë kategori ekonomike është e bazuar edhe në shpenzimet e krijuara nga vitet paraprake për këto qëllime.

### **Shërbimet e telekomunikimit**

Shpenzimet për shërbime të telekomunikimit janë të bazuara në të dhënrat historike nga vitet paraprake, si për shpenzimet e telefonit mobile, shpenzimet te veçanta për internetin e ASHNA-së, shpenzimet postare, Shpenzimet për ASHNA për paisje të navigimit (linjat e dedikuara, Golesh, Gërm, Gjakovë, Shkup, Tiranë), si dhe paisjet tjera të teknologjisë informative.

### **Shpenzimet për shërbimet**

Shpenzimet më të larta janë planifikuar shërbimet arsimore trajnuese, ku marrin shumën kryesore të kësaj kategorie ekonomike në të cilën janë trajnimet e rregullta për mbajtje të licencave dhe kompetecës siç është e rregulluar përmes Rregulloreve në fuqi të Autoritetit të Avionit Civil, si dhe trajnimin e kontrollloreve të rinjë etj, konferenca, licenca per staf (mjekesore profesionale). Në këtë linjë janë përfshirë edhe shërbimet për shypje të librarive të ndryshme për nevojat operacionale si harta dhe raporte të ndryshme periodike. Shpenzimet tjera kontraktuese përfshijnë shpenzimet e dezinfektimit dhe shpedicionit. Në këtë kategori janë të përfshira gjithashu Dizajni dhe projektimi me kontraktorë të specializuar për dizajn dhe projektim (planifikohet zgjerimi i zyreve të meteorologjisë, zyreve të sigurimit, rregullimi i hapësirave të përbashkëta të ASHNA-së jashtë objekteve – obori (përfshihen pastrimi nga mbetjet e gurëve dhe zallit, hedhja dhe shperndarja dheut te ri, barë i ri, pemë, ndërtimi i dy verandave ne lokacion te caktuar dhe mbyllja e hapsirës për duhan), dizajnimi dhe projektimi për zyre e reja në objektin e ri me përshtatje dizajni dhe projektimi për punën e zyreve të avionit, dizajni i parkingut të ri dhe energjisë së ripërtritshme dhe hapësires per duhan. Shpenzimet për konsulencë – Përfaqësim përfshirë edhe dhe certifikim per ISO Standardet. Shpenzimet për anëtarësim. Shpenzimet për shërbimet e AFTN të cilat merren nga ISAVIA, ndërsa te shpenzimet për shërbimet teknike janë të përfshira tarifat e certifikimit nga Autoriteti i Avionit Civil të Kosovës, si dhe licencat vjetore nga EUMETSAT dhe ARKEP. Licenca vjetore EUMETSAT, Tarifat e AACK-së per siguri etj. Shërbime të veçanta. Te nënkategorië e shpenzimeve për anëtarësim është paraqitur shuma e shpenzimeve të tarifës vjetore të anëtarësimit në Organizatën Civile për Shërbimet e Navigacionit Ajror (CANSO), shërbime konsulente, Quality Management System Certifikim me ISO 9001/2015.

### **Blerja e mobiljeve dhe pajisjeve me më pak se 1000 Euro**

Në këtë kategori janë të planifikuara kërkesat për pajisjet e sigurimit dhe paisjeve tjera hardverike si dhe mjete tjera sipas nevojes për njësítë e mbështetese. Si dhe blerjet tjera të inventarit të imët për zyrë përfshirë edhe shporta, ulëse, kositese bari, gëershër pemësh etj. nga Departamentet e ASHNA-së të cilat nuk i përkasin kategorisë se kapitaleve.

### **Blerjet tjera të mallrave dhe shërbimeve**

Në këtë linjë janë të paraqitura shpenzime përfshira me furnizim e zyrëve si furnizim përfshira me ushqim dhe pije ku edhe kemi paraqitur furnizimet me ujë përfshira me higjienë janë të përfshira shpenzimet e materialit hixhenik përfshira me hapësirave të ASHNA-s, përfshirë objektin e ri të ASHNA – Zyret e reja përfshirë tre klima per kullen, Ngjyrosja e objektit të kulles me ngjyrë rezistente – Nga bazamenti deri lartë tek zyret e kulles ku operojne kontrollorët, veshmbathjeve që është paraqitur nevoja e furizimit me uniforma përfshira me punëtorët e sigurimit dhe te teknikës së ASHNA-s.

### **Derivatet dhe lëndët djegëse**

Në këtë kategori janë të përfshira të gjitha shpenzimet që janë të lidhura me derivatet e naftës e që ASHNA ka përfshira me vetura, përfshira me gjeneratorët në lokacionet ku janë të vendosura paisjet dhe objekti si dhe vaj përfshira me navigacionit si dhe per automjete te ASHNA-se. Këto shpenzime janë të bazuara në shpenzimet e vitet e kaluara përfshira me këtë kategori të shpenzimeve.

### **Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve**

Në mjetet e planifikuara përfshira me këtë kategori janë të përfshira shpenzimet e kontraktuara me tenderim përfshira me sigurimin e operimeve të ASHNA-së që kërkohet nga AACK përfshira me shërbimeve, sigurimin e aseteve te ASHNA-se si dhe sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve në shfrytezim të ASHNA-se.

### **Mirëmbajtja**

Mirëmbajtja e paisjeve të teknologjisë informative, mirëmbajtjet përfshira me sistemet e navigacionit ajror, mirëmbajtjet e gjeneratorëve, mirëmbajtjet e rrjetit elektrik brenda hapësirave të ASHNA-së, mirëmbajtja e kondicionereve të ajrit, mirëmbajtja e liftit, mirëmbajtja e softverit Navision si dhe kalibrimi i paisjeve të navigacionit nga ajri proces që kryhet dy herë brenda vitit nga kompania licencuara per kete shërbim (dy ILS ne Përdorim dhe DVOR/DME).

### **Shpenzimet e marketingut**

Planifikimi i shpenzimeve të marketingut është i bazuar në kërkesat dhe nevojat e njësive organizative të ASHNA-se përfshira me vitin 2023-2025.

Në këtë linjë të shpenzimeve bëjnë pjesë: publikimet e ndryshme të ASHNA-së, konkursset e ndryshme përfshira me nevoja të ASHNA-së, botimet e broshurave, udhëzuesve, informatorëve të ndryshëm, gazetave zyrtare etj.

### Shpenzimet e Përfaqësimit-Reprezentacionit

Shpenzimet e përfaqësimit janë minimale dhe të bazuara në Udhëzimin Administrativ të Qeverisë që përcakton lartësinë e tyre në agjenci dhe personat që kanë të drejtë shfrytëzimi.

### Shpenzimet e Pagesave – Vendimeve Gjyqësore

Detyrimet kontingjente të ASHNA-së të vlerësuara (Ne bazë te aktgjykimit te gjykatës themelore te Prishtinës dhe nga dega në Lipjan). Detyrimet kontingjente të ASHNA-së të vlerësuara kryesisht janë duke të bazuara në paditë e paraqitura në emër të ANP-së, tani si trashëgimtarë ASHNA. Lëndë e Kontrollorëve të Trafikut Ajror me C.nr 635/14 me shumën mbi 550,000 euro (në emër të mospagesës së vikendeve). Një lëndë tjeter të ankimimit poashtu nga kontrollorët e trafikut ajror për punët jashtë orarit me vlerë mbi 100,000 euro. Kërkesa tjera kemi nga ish pronarët e pronave të ekspropriuara brenda rrëthojës që ende s'janë paguar. Vetëm në fund të vitit 2019 kanë paraqitur kërkesa për lirimin e pronave dhe kompensimin e tyre mbi 2. ha të pa kompenzuara. Ne ende nuk kemi pranuar kurfarë padie, vetëm kërkësat tyre me shkrim ekzistojnë. Në bazë të kalkulimeve pararake, vlera e perafërt mund te sillet deri mbi 500,000 euro.


Psh disa janë si vijon: Agjencia e Sherbimeve të Navigacionit Ajror me datë 28.10.2019 ka pranuar dy kërkesa per lirimin e patundshmërisë së uzurpuar, të cilën Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror në afat ligjor përgjigjeje me shkrim në kërkese. Agjencia e Sherbimeve të Navigacionit Ajror pasi është njofuar për kërkësen me të cilën e konsideron se kanë filluar me Padi për toka me nr 00620/10.00620/11.00620/12.00620/13.00620/20 = 193.11 (ari) dhe një me nr 0029/1, 0029/2 prej 0. 20 (ari)

**Tabela me shënimë - kategoria Shpenzime Komunale**

Nr	Kufijtë/buxhetor 2023-MF	Kërkesa 2023 ASHNA
1	162,370	119,500

Nr	Përshkrimi	Buxheti 2022	Vlerësimet 2023	Vlerësimet 2024	Vlerësimet 2025
1	SHPENZIMET E KOMUNALIVE	112,370	119,500	122,000	122,000

Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror llogaritjen e kategorisë së shpenzimeve komunale e ka bazuar në faturat e furnizimit për shpenzimet e bëra ndër vite si dhe në pjesën e parë të vitit 2022. Në këtë kategori ka rritje të shpenzimeve komunale në masën e mjeteve të kërkuar për buxhetin e vitit 2023-2025 sepse ka shtim të paisjeve të reja, si dhe ngritjen të çmimeve të shërbimeve nga kompanitë publike.



Njësia Organizative: ASHNA

Nr. Ref. /Kodi: PBV-2023


Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 38 nga 48

**Kërkesa buxhetore te kategoría Kapitale**

Pasuria	Burimi i financimit	Investimi gjate 2023	Investimi gjate 2024	Investimi gjate 2025
Sistemi i Ri i Procesimit të të dheneve ATM	GQ	714,223	1,491,787	1,940,744
Paisje të teknologjisë informative	GQ	80,000		
Pjesë rezervë për DVOR	GQ	60,000	30,000	
Multilateration	GQ	300,000	350,000.00	581,043.00
AMHS	GQ	50,000	380,000.00	
Radio Emergjente - Implementimi i planit kontigjent	GQ	20,000		
Sistemi Manual Meteorologjik	GQ	20,000		
Qasja rrugore në Radarin e Gjakovës	GQ	10,000		
Mbuloja e gjeneratorëve dhe rezervuarit të naftës Gjakovë	GQ	3,000		
Furnizimi me inventar për nevoja operative	GQ	130,000	10,000.00	
Rregullimi dhe renovimi i hapësirave të Punës	GQ	94,000	10,000.00	
Rregullimi i parkingut për vetura	GQ	100,000		
Dylbi (KTA)	GQ	1,800		
Sistemi i Ri i Procesimit të të dheneve ATM	THD	789,237		
Energji e ripërritshme	GQ	149,527	250,000.00	
Subtotal - Të hyra të dedikuara		789,237		
Subtotal - Grante qeveritare		1,732,550	2,521,787	2,521,787
<b>Total</b>		<b>2,521,787</b>	<b>2,521,787</b>	<b>2,521,787</b>



Njësia Organizative: ASHNA

Nr. Ref. /Kodi: PBV-2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 39 nga 48

## SISTEMI I PROCESIMIT TË TË DHËNAVE ATM

Projekti i sistemit ATM mundëson ngritjen e kapaciteteve teknike të ASHNA-s për kontrollimin e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës, përfshirë këtu hapësirën e ulët dhe të lartë ajrore. Është esenciale që ASHNA të ketë kapacitetet e duhura teknike dhe njerëzore për ta ofruar këtë shërbim. Rrjedhimisht, kontrollimi i tërë hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës është prioritet i ASHNA-s.

Për momentin, ASHNA është duke operuar me një sistem të vjetër ATM (të instaluar në vitin 2004), dhe përpos faktit që sistemi është shumë i vjetër, edhe mundësitet i ka shumë të kufizuara. Si i tillë, mundëson kryerjen e punëve bazike por nuk ofron fleksibilitet të mjaftueshëm për realizimin e objektivave të ASHNA-së.

Për ofrimin e shërbimeve në hapësirën e lartë ajrore, (ACC-Area Control Center), procedurat që duhet të zbatohen janë të specifikuara në ICAO Aneksi 11 dhe për këtë arsyе nuk janë përsëritur këtu. Megjithatë, ka disa aspekte të cilat duhet të merren në konsideratë kur planifikohet një qendër e tillë kontrolli, në lidhje me ofrimin e shërbimit të ACC-s, të cilat duhet të janë të theksuara për shkak të kostos së tyre të zbatimit, afatit kohor të implementimit dhe efektit domethënës me ndikim në procedurat aktuale të zbatueshme dhe operacionale në ASHNA.

Përveç procedurave të përcaktuara në ICAO ANEKSIN 11 fokus i veçantë i është dhënë procedurave të koordinimit, sistemeve ekzistuese RADAR-ike, integrimit dhe organizimit të hapësirës ajrore dhe sistemit ekzistues ATM.

Koordinimi me njësitë e tjera ATC ndahet në;

- Koordinimi me ACC-të fqinje (Shkup, Tiranë, Podgoricë dhe Beograd)
- Koordinimi me njësitë e tjera ATC që ofrojnë shërbime brenda FIR-it të njëjtë dhe shërbehen nga ACC në fjalë, dhe
- Koordinimi në mes të Pozicioneve Operuese brenda njësisë ACC

Me rëndësi për ACC-n është edhe:

- Integrimi i figurës së RADAR-it dhe ndarja e saj me njësite e tjera ACC (sharing) që perdonin sistemin RADAR-ik
- Organizmi i Hapësirës Ajrore dhe ATS "Routes" (rrugëve ajrore)

Është objektiv i ASHNA-së, që të parandalojë përplasjen në mes të aeroplaneve, të përshpejtoj dhe mbajë rrjedhë të rregullt të trafikut ajror, që të ofrojë këshilla dhe informacione të dobishme për realizimin e sigurt dhe efikas të fluturimeve, që t'i njoftojë organizatat përkatëse në lidhje me avionët në nevojë për kërkim-shpëtim dhe të ndihmojë organizatat e tilla sipas nevojës.

Objektiv tjetër i ASHNA-s, është që gjatë ofrimit të Shërbimeve të Trafikut Ajror në hapësirën e lartë ajrore të Kosovës, të sigurojë përmbrushjen e të gjitha kërkesat të vëna me Rregulloren e Këshillit Evropian 2096/2005 siç është përcaktuar në ligjin e Avacionit Civil të Kosovës. Qëllimi i këtij projekti është që në raport me kërkesat operative dhe teknike si dhe nevojave që kanë dalë si rrjedhojë e rihapjes së hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës për mbifluturime, të argumentoj arsyeshmërinë e implementimit të një sistemi të ri të Prosesimit të të dhënave (ATM).

Me sistemin ATM, do të ndërrohen të gjithë serverët, duke bërë kështu të mundshme implementimin e veglave të cilat me vështirësi po mund të implementohen në sistemin aktual të procesimit të të dhënave. Sistemi i ri i ATM do të mundësoj një koordinim të qetë përmes implementimit të FDP-së re dhe



Njësia Organizative: ASHNA

Nr. Ref./Kodi: PBV-2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Faqë 40 nga 48

ndërlidhjes me fqinjët përmes shërbimit OLDI. Në këtë mënyrë do të rritet niveli i sigurisë së fluturimeve dhe do të rritet mundësia e menaxhimit më të sigurt të numrit shumë më të madh të fluturakeve.

Qëllim tjetër i këtij projekti është të argumentoj implementimin e një sistemi të ri të procesimit të të dhënave i cili do të bazohet në standardet më të larta ndërkombëtare të avionit civil. Këto standarde bazohen në dokumentet e organizatave ndërkombëtare të Avionit Civil - ICAO, EASA dhe Eurocontrol.

Pra, me implementimin e këtij projekti do të arrihet modernizimi i pajisjeve dhe ecja me hapat e zhvillimit teknologjik në përputhje me standardet ndërkombëtare të avionit civil.

#### FURNIZIM ME PAISJE TË TEKNOLOGJISE INFORMATIVE

Planifikimi i investimit në teknologji informative është bërë si rrjedhojë e nevojës së furnizimit me pajisje të TI-së për sisteme të cilat ofrojn një qëndrueshmëri të sistemeve dhe siguri të tyre dhe stafit, si dhe TV për nevoja të ASHNA-së.

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin 2023 ka planifikuar furnizimin me pajisje të Teknologjisë Informative për sisteme dhe stafin e saj, si dhe pajisje të TI-së të cilat ofrojnë një qëndrueshmëri të sistemeve dhe siguri të tyre.

Gjithashtu, është planifikuar furnizim me servera dhe "storage për backup" dhe dokumente, virtualizimin e sistemeve dhe ruajtjen e të dhënave në një lokacion tjetër jashtë ASHNA-së.

Në planifikim përfshihen edhe kompjuterë, monitora, Workstation, USB, RAM dhe HDD External. Situata aktuale me kompjuterë për stafin e ASHNA është stabile. Kompjuterët më të vjetër datojnë nga viti 2018. Duke marrë parasysh jetëgjatësinë e tyre, brenda këtij afati 2023-2027 planifikohet të bëhet furnizimi me kompjuterë të rinjë për t'i zëvendësuar këta aktual.

Është paraparë edhe prokurimi dhe instalimi i sistemit të prezencës dhe qasjes (access control), pasiqë sistemet ekzistuese janë të limituara në numër të përdoruesve dhe janë shumë të vjetër që do të thotë se edhe mirëmbajta e tyre është e pamundur..

Këto furnizime kanë për qëllim krijimin e lehtësirave në punë dhe sigurinë e sistemeve aktuale dhe ruajtjen e dokumenteve për një kohë më të gjatë, krijimin e ambienti të lehtë të punës me pajisje bashkëkohore si dhe arritjen e standardeve të kërkova të Agjencinë. Të gjitha këto pajisje, në tërësi bëjnë të mundur një funksionim më të sigurtë të agjencisë drejt arritjes së objektivave të saj.

Ndryshimet teknologjike kërkojnë përshtatje në sisteme prandaj edhe planifikimet vjetore TI do ti bazojë krahas këtyre ndryshimeve duke i përshtatur me nevojat e ASHNA.

#### PJESË REZERVË PËR SISTEMET E NAVIGIMIT DVOR

Është standard ndërkombëtar në avionin civil, që për çdo sistem të ekzistojë stoku i pjesëve rezervë. Këtë standard synojmë ta arrijmë me këtë projekt, dhe kështu ti plotësojmë standardet ndërkombëtare të tranzpozuara në rregulloret e AAC-së.

Projekti për pjesë rezervë për sistemin e DVOR/DME - SELEX është një projekt shumë i nevojshëm si për nga aspekti operativ dhe teknik, poashtu edhe nga aspekti i sigurisë së operimeve. Mirëmbajtja dhe funksionimi i këtij sistemi mund të garantohet vetëm me stokun e pjesëve rezervë.

Sa i përket sistemit ILS, janë dy sisteme të instaluara në të dy anët e pistës dhe të komisionuara në vitin 2022 si pjesë e projektit për zgjatje të pistës. Këto dy sisteme janë nën garancion 3 vjeçar (1 vit pothuajse

ka kaluar). Poashtu, për këto dy sisteme kemi pranuar edhe disa pjesë rezervë të cilat janë të mjaftueshme në këtë fazë. Për këtë sistem nuk planifikojmë të furnizohemi me pjesë rezervë gjatë vitit 2023, ndërsa nga viti 2024 do të kemi një pasqyrë më të qartë në raport me problemet me të cilat mund të ballafaqohemi, dhe rrjedhimi shërbimeve edhe të nevojës për pajisje me pjesë rezervë.

#### MULTILATERATION (MLAT)

ASHNA ka të instaluar Sistemin RADAR-ik MSSR Mode S në Golesh dhe MSSR Mode S/I në lokacionin e aeroportit të Gjakovës. Sistemi MSSR Mode S/I aktualisht është në fazë finale të miratimit nga AAC dhe për momentin nuk përdoret në ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror. Keto sisteme te survejimit shërbijnë për të mbuluar hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Ato shfrytëzojnë radio-frekuenca për transmetim dhe pranim të sinjalit RADAR-ik, të cilat frekuanca janë të aprovuara nga organizatat ndërkombëtare të aviacionit civil ICAO (International Civil Aviation Organization) dhe Eurocontrol.

Me sistemet ekzistuese të survejimit mundësohet përcjellja e fluturakeve prej momentit kur hyjnë në hapësirën ajrore të Kosovës, deri në aterrim dhe dhe anasjelltas në shkuarje. Duke pasur parasysh nevojat operative që do të kemi në të ardhmen, siq janë marrja e kontrollit në hapësirën e lartë ajrore të Republikës së Kosovës dhe hapja e korridoreve të reja ajrore me shtetet fqinje, do të paraqitet nevoja e një organizimi të ri të hapësirës se kontrolluar ajrore.

Ky aranzhim nënkuption hapjen e zonave të reja të fluturimeve në nivele të caktuara. Me këtë rast, përpos shërbimeve APP dhe TWR (që edhe ato janë të ndara në disa zona) do të ofrohet edhe shërbimi ACC (Area Control Center) që nënkupton kontrollin e fluturimeve në hapësirën e lartë ajrore. Argument shtesë është edhe instalimi i sistemit të aterrimit instrumental CAT IIIb i cili kërkon saktësi më të madhe dhe vëzhgim më të mirë, përfshirë edhe kontrollin e automjeteve që operojnë në hapësire manovruese përmes sistemeve të survejimit.


Duke shfrytëzuar të dhënat e survejimit, kontrollori i trafikut ajror vrojton dhe udhëzon fluturaket në zona të caktuara gjatë rrugëtimit në hapësirën ajrore në përgjegjësinë e tij. Hapja e zonave të reja, rrugëve të reja ajrore dhe rritja e vazhdueshme e numrit të fluturimeve, duke pasur parasysh këtu edhe kriteret strikte për siguri në aviacion nga ICAO, EASA dhe Eurocontrol, implikon domosdoshmérinë përpaisje më të sofistikuara të Sistemit RADAR-ik.

Gjithashtu, me këtë projekt kemi marr parasysh edhe nevojën operative, që secila zonë e kontrolluar e hapësirës ajrore të Kosovës, të ketë mbulueshmëri të trefishtë.

Megjithëse Sistemi RADAR-ik aktual është i besueshëm, koha e përdorimit të tij është duke kaluar. Duke e patur parasysh këtë fakt, e kemi parë të nevojshme të pajisemi me senzor të ri të survejimit (MLAT, ADS-B ose me ndonjë lloj tjeter të Sistemit të vrojtimit) i cili sistem do ta plotësonë për momentin, e më vonë plotësisht të zëvendësojë sistemin ekzistues.

Me këtë sistem mundësohet përcjellja e fluturakeve në hapësirën manovruese (në tokë) si dhe në ajër, në varshmëri nga numri i senzorëve të instaluar. Poashtu, mundësohet një fleksibilitet më i madh i mbulueshmerisë, meqenëse numri i senzorëve mund të rritet në varshmëri nga zonat që janë me interes për tu kontrolluar/mbuluar. Sistemi MLAT mundëson edhe shfrytëzimin e të dhënave ADS-B, meqenëse është i integruar në këtë sistem.

Për të pasur një siguri të lartë të fluturimeve gjatë tërë kohës, primare është që në asnjë rast nuk duhet të ndërprenet survejimi i fluturakeve me RADAR, e kjo mund të arrihet me posedimin e më shumë sistemeve radarike.



Njësia Organizative: ASHNA

Nr. Ref. /Kodi: PBV-2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 42 nga 48

## AERONAUTICAL MESSAGE HANDLING SYSTEM AHMS

Për dërgimin dhe pranimin e mesazheve të koduara, të planeve të fluturimeve dhe mesazheve meteorologjike, ASHNA përdorë sistemin AFTN. Kjo formë e dërgimit dhe pranimit të mesazheve në shumë shtete është e tejkaluar, sepse kanë kaluar në platforma tjera konform rregullave dhe standardeve të fundit të ICAO-së, EASA-s dhe Eurocontrol-it.

Këto standarde, obligojnë shtetet që të kalojnë/migrojnë në sisteme më të avancuara të dërgimit dhe pranimit të mesazheve (informatave aeronautike), nga AFTN në AHMS.

Në shumë shtete kjo nismë ka filluar qysh nga 2010, ku janë implementuar sistemet e para të AMHS dhe më pastaj edhe linjet në mës shteteve anëtare në formë të AMHS.

Shtetet që akoma nuk kanë migruar në sistemet AMHS, apo akoma përdorin sistemin AFTN, janë të obliguara të implementojnë "Gateway" (konverter Hardwerik dhe softwerik), në mënyrë që mesazhet e pranuara në formatin AMHS t'i konvertojnë në formatin e mesazhit të AFTN-së dhe anasjelltas.

Tanimë shumë shtete të botës kanë implementuar sistemet e dërgimit të mesazheve aeronautike në formatin AMHS, sepse sistemet në formatin e mesazheve AFTN janë duke u larguar nga perdorimi. Kjo ndodh për arsyet përmbrushjeve të obligimeve të dala nga organizatat ndërkombëtare për aviacion civil, dhe formati i mesazheve të AMHS janë më të avancuara si për nga formati i mesazhit, poashtu edhe për nga siguria e tyre.

Edhe ASHNA duhet të funksionoj konform këtyre standardeve që burojnë nga organizatat botërore të aviacionit civil dhe në ardhmen e afërt duhet të bëjmë përgaditjet për migrim nga sistemi AFTN në AHMS.

Migrimi, sipas ICAO Doc 9880 (Part II, section 3.4) i ka dy nivele "Basic ATSMHS"-Nivelin bazik dhe Extended ATSMHS-Niveli I Zgjeruar, por neve si ASHNA do të percaktohem për nivelin e zgjeruar të implementimit. Shpresojm që në të ardhmene afert të implementohet ky projekt, dhe më këtë të plotesohen standardet e kohes, konform obligimeve dhe standardeve të aviacionit.

## RADIO EMERGJENTE - IMPLEMENTIMI I PLANIT KONTIGJENT

Plani kontigjent i ASHNA-së parasheh edhe rastet kur kontrollorët e trafikut ajror duhet të evakuohen nga pozitat operuese. Në këto raste KTA duhet të bëjnë pastrimin e qiellit duke i transferuar fluturaket në kontrollë të njësive fqinje. Për të realizuar pastrimin e qiellit, kontrollorët duhet të kenë radio emergjente (portabël), përmes të cilave do të mund të komunikonin me fluturaket gjatë evakuimit dhe/ose nga një lokacion tjetër i paraparë me planin kontigjent. Me këtë projekt do të përbushen kërkesat e rregullores së AAC-së 09/2020 e cila tranzpozon rregulloren e Komisionit European EU reg.373/2017).

## SISTEMI MANUAL METEOROLOGJIK

Një sistem manual meteorologjik (Met garden) për përdorim emergjent që do të përfshinte: 2 Stivenson Screen (me termometra max dhe min si dhe dry e wet bulb) shtuar edhe 8 termometra të tillë rezervë, 1 pluviograf (rain gauge) statik, 1 anemometër dore, 1 matës mobil të bubullimave, 1 matës diellëzimi, një matës ere me shpejtësi dhe drejtim (në shtyllë 2m)- vlera e supozuar 12.000 euro. Këto paisje do të gjejnë përdorim pa marrë parasyshë implementimin e projekteve nga zgjatja e pistës, meqë me rastin e mosfunkcionimit të sistemeve të vrojtimit, ne gjithnjë do të kemi mundësi që të ofrojmë shërbimet minimale meteorologjike dhe se këto paisje poashtu do të përdoren edhe për krahasueshmërinë e të dhënavë të parametrave meteorologjik.

Njësia Organizative: ASHNA

Nr. Ref. /Kodi: PBV-2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Faqë 43 nga 48



## **QASJA RRUGORE NË RADARIN E GJAKOVËS**

Gjatë vitit 2022 është finalizuar instalimi i radarit MSSR Mode S/I në lokacionin e aeroportit të Gjakovës. Hapësira mes rrugës dhe lokacionit të Radarit duhet të shtrohet me material të ngurtë (asfalt, beton) në mënyrë që të kemi qasje më të lehtë në lokacion dhe të mos barten papastërtitë brenda në hapësirën ku gjendet radari. Gjatësia e kësaj rruge është përafër sist 20 metra.

## **MBULOJA E GJENERATORËVE DHE REZERVUARIT TË NAFTËS (LOKACIONI RADARI GJAKOVË)**

Për të siguruar punën e pandërprerë të radarit edhe në rastet kur nuk ka energji elektrike, janë siguruar gjeneratorët. Gjeneratorët duhen të mirëmbahen për të garantuar se do të jenë në gjendje të furnizonë radarin me energji elektrike. Pjesë e mirëmbajtjes është edhe ruajtja nga kushtet e këqija të motit. Për këtë qëllim, duhet të ndërtohet një mbulojë e cila i mbron gjeneratorët dhe rezervuarin nga kushtet e këqija klimatike dhe si rrjedhojë zgjatet jetëgjatësia e tyre.

## **FURNIZIMI ME INVENTAR PER NEVOJA OPERATIVE**

Nevoja për sigurimin e një ambienti të përshtatshëm për punë, ka të bëjë me plotësimin e standardeve ndërkontrolluese nga fusha e aviacionit civil, të cilat na obligojnë që personelit operativ të i u sigurohen kushte të mira për punë, konform nivelit të përgjegjësisë së tyre profesionale.

Standardi i cilësisë së lartë të inventarit (karrigeve të punës, sofave për ç'lodhje ditore) është i nevojsnem si pasojë e punës me stres dhe presion që kanë personeli operativ dhe gjithashu edhe puna gjatë 24 orëve, kërkon kushte për të mundësuar që zyrtarët të jenë të koncentruar në punë dhe shërbimi të kryhet pa vështirësi. Brenda projektit është paraparë edhe furnizimi me inventarë për hapësirat e reja të ASHNA-së, të cilat janë ne fazën përfundimtare të punimeve.

## **RREGULLIMI DHE RENOVIMI I HAPËSIRAVE TË PUNËS**

ASHNA ka shtuar kapacitetet e saj në dhënien e shërbimeve dhe si rrjedhojë disa hapësira brenda objekteve të ASHNA-së, të koncentruara në pjesën operative, nevojitet të rregullohen dhe renovohen me qëllim të sigurimit të kushteve më të mira për punë. Planifikohet edhe rregullimi i hapësirave të përbashkëta të ASHNA-së jashtë objekteve – oborri (përfshihen pastrimi nga mbetjet e gurëve dhe rërës, hedhja dhe shperndarja dheut të ri, barë i ri, pemë, ndërtimi i dy verandave në lokacion të caktuar, mbyllja e hapësirës për duhan dhe shtrirja e sistemit të ujtitjes pikë pikë). Planifikohet riparimi i zyrës së meteorologjisë, zyrës së sigurimit - riparimi i ndërtesave sipas nevojës.

## **RREGULLIMI I PARKINGUT PËR VETURA**

ASHNA në mungesë të parkingut për veturat e të punësuarve, shfrytëzon parkingun e LIMAK-ut përballet ndërtesës së ASHNA-së, i cili është i vogël për të akomoduar të gjitha veturat dhe kështu shkaktohen tollovi dhe ndikon në stresin e personelit. Për ti mundësuar personelit parking të mjaftueshëm është e nevojshme ndërtimi i parkingut për veturat e personelit të ASHNA-së. Ky parking ndërlidhet edhe me projektin për energji të ripërtëritshme pasi që do të jetë i mbuluar dhe në kulm do të vendosen panelat solar. Për më shumë, në këtë parking do të vendosen edhe stacionet për mbushje të veturave elektrike (charging station).

## DYLBI (KTA)

Dylbitë profesionale janë të nevojshme për punë operacionale qe lidhen me ofrimin e shërbimeve të sigurta. Gjatë procesit të aterrimit të fluturakeve, KTA përdorë dylbi për të përcjellur nga largësia këtë proces.

## PROJEKTI I ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME

Nga raportet e përbledhura vjetore mbi konsumin dhe shpenzimet e energjisë elektrike të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, si dhe nga parashikimet për vitet në vijim, kuptojmë për ngritje të konsumit të energjisë elektrike, rrjedhimisht edhe të shpenzimeve.

Konsiderojmë se është e dobishme dhe momenti i duhur për të filluar dhe zbatuar një plan për konsum racional të energjisë në ASHNA.

Ky plan/ projekt, përveç tjerash do përkonte edhe me objektivat e Republikës së Kosovës në eficiencën e energjisë, burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Nga observimet dhe komunikimet e zhvilluara me ekspert të kësaj fushe, kemi kuptuar se një projekt i tillë, nënkupton insatalimin e sistemeve përkatëse dhe të avancuara, që do instaloheshin në premisat e ASHNA-së dhe të cilat me kohë do mundësonin shfrytëzimin e plotë të energjisë së ripërtërishme për nevojat e ASHNA-së.

## **10. Rreziqet dhe ndikimi në planin e biznesit**

Në përpilim e këtij plani, sigurisht që kemi marrë në konsdideratë dhe rreziqet potenciale, të cilat i trajtojmë përmes Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë dhe me procesin e Menaxhimit të Rreziqeve. Në vijim do paraqesim një përbledhje të rreziqeve.

- **Rreziqet e jashtme** - janë rreziqet që reflektojnë rr Ethanat Jashtë organizatës;
- **Rreziqet ligjore** - janë rreziqet që reflektojnë rr Ethanat ligjore të organizatës;
- **Rreziqet financiare** - janë rreziqet që lidhen me disponueshmërinë e burimeve të nevojshme;
- **Rreziqet për burimet njerëzore** - janë rreziqe operative që shoqërohen në mënyrë specifike me çështjet e personelit;
- **Rreziqet operative** - janë rreziqet e punës që do të mund të ndikonin zhvillimin e veprimtarisë



Njësia Organizative: ASHNA


Nr. Ref. / Kodi: PBV-2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Faqe 46 nga 48

## 11. Skema organizative e ASHNA-së



## 12. Azhurnimi i Planit Vjetor të Biznesit

Ky plan vjetor i biznesit azhurnohet bazuar në ndryshimet që afektojnë planin vjetor të biznesit dhe domosdoshmërisht azhurnohet në baza vjetore.



Samir Bllacaku



Drejtør



Njësia Organizative: ASHNA

Nr. Ref. / Kodi: PBV-2023

Ver.: 1.0

Data e Ver.: 14.11.2022

Adresa: Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Vrellë, Lypjan, 10070, Republika e Kosovës

Faqë 48 nga 48